



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 1023/1 Prot.

Tiranë, më 29.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 145, datë 29.05. 2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar mori në shqyrtim ankesat: nr. 271 Regj., datë 25.11.2025, paraqitur nga I.N; nr. 272 Regj., datë 25.11.2025, paraqitur nga L.N; nr. 273 Regj., datë 25.11.2025, paraqitur nga N.Sh dhe V.Sh; nr. 274 Regj., datë 25.11.2025, paraqitur nga M.C dhe R.C; nr. 275 Regj., datë 25.11.2025, paraqitur nga P.P; nr. 277, datë 26.11.2025, paraqitur nga L.T; nr. 278 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga G.H; nr. 279 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga T.M; nr. 280 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga F.S; nr. 281 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga F.R; nr. 282 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga V.B; nr. 283 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga Y.C; nr. 284 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga A.M; nr. 285 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga S.M; nr. 286 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga P.D; nr. 287 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga A.M; nr. 288 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga A.I; nr. 290 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga Th.A; nr. 291 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga A.L; nr. 292 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga A.M; nr. 293 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga S.J; nr. 294 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga V.K; nr. 295 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga B.S; nr. 296 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga J.N; nr. 297 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga I.K; nr. 298 Regj., datë 26.11.2025, paraqitur nga L.H; nr. 304 Regj., datë 03.12.2025, paraqitur nga R.M, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sha, në të cilat pretendohet diskriminim, për shkak të “racës”, “aftësisë së kufizuar”, “gjendjes familjare”, “gjendjes civile”, “gjendjes shëndetësore” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave të sipërcituara, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjekteve ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, respektivisht subjektet, parashtrojnë si më poshtë vijon:

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

1. **Z. I.N<sup>2</sup>**: “Jam kryefamiljar, nga komuniteti rom, me 5 fëmijë, në pritje të fëmijës së gjashtë, të gjithë minorenë. Në vitin 2020 e kam ndërprerë pagesën e energjisë elektrike për shkak të pamundësisë financiare. Tani jam në punë tek kompania e pastrimit Eco Tirana. Para dy javësh është ndërprerë furnizimi me energji elektrike, për shkak se jam debitor. Nëse bëhet një Akt-Marrëveshje, kërkoj të paguaj faturën e muajit dhe shumën prej 1.000 deri 1.500 lekë në muaj. Kontrata nr: T-634421”.
2. **Znj. L.N<sup>3</sup>**: “Jam kryefamiljare, nga komuniteti rom, mbetur e ve që në vitin 1990. Jetoj në apartament 1+1, me djalin e sëmurë me epilepsi dhe shëndet mendor. Djali nuk merr KEMP dhe nuk kemi asnjë mbështetje financiare nga shteti. Në vitin 2018 e kam ndërprerë pagesën e energjisë elektrike, për pamundësi financiare. Para dy javësh është ndërprerë furnizimi me energji elektrike, për shkak se jam debitore. Nëse bëhet një Akt-Marrëveshje, kërkoj të paguaj faturën e muajit dhe shumën prej 1.200 deri 2.000 lekë në muaj. Kontrata nr: T-634240”.
3. **Z. N.Sh dhe znj. V.Sh<sup>4</sup>**: “Jam kryefamiljar, i martuar, me 5 fëmijë, 2 të martuar, Jetojmë në banesë sociale, ap. 2+1, 5 veta, sipas certifikatës familjare. Jemi debitor në OSHEE që nga viti 2018. Kjo për shkak se unë si kryefamiljarë jam i sëmurë me KEMP të përhershëm, sepse kam bërë 2 operacione në zemër, përveç sëmundjeve të moshës, hipertension, diabet. Gruaja është e sëmurë me tumor në mitër. Ka bërë operacion, kimioterapi. Pra, gjendja ekonomike dhe shëndetësore në familje nga ne si bashkëshortë është e rënduar dhe e pamundur për të siguruar të ardhura. Unë si bashkëshort marr një KEMP në vlerën 6000 lekë të reja plus 3000 lekë ndihmë nga bashkia. Ne duam të lidhet energjia dhe të nënshkruajmë një akt marrëveshje me OSHEE për shlyerje graduale të shumës së debisë. Ne duam të vendosen sahatë të rinj matës të energjisë sepse faturat që na vijnë janë shumë të larta për një shtëpi që ka vetëm një dush që rri ndezur. Faturat më duken fiktive dhe abuzive. Ne jemi në gjendje që me shumë sforco dhe me ndihmën e punës së fëmijëve të sigurojnë vetëm pagesën e faturës mujore dhe një vlerë 20-30 mijë lekë të vjetra në varësi të faturimit mujorë. Ne i përkasim komunitetit rom dhe egjiptian. Numri i kontratës: 634237”
4. **Znj. M.C dhe z. R.C<sup>5</sup>**: “Jam kryefamiljar dhe jemi 6 veta në familje, jemi egjiptian: burrë, grua dhe 4 fëmijë. Vetëm unë si kryefamiljar kam qenë në marrëdhënie pune dhe punoja në një kompani ngarkim shkarkimi. Kemi qenë klient të rregullt me pagesën e energjisë elektrike deri në vitin 2022 kur unë si kryefamiljar, pësova një aksident dhe nuk isha më në marrëdhënie pune. Kjo solli dhe ndërprerjen e energjisë elektrike për shkak se jemi debitor prej 3 vitesh në një shumë 4 milion lekë të vjetra. Bashkëshortja nuk punon dhe nuk trajtohet as me ndihmë ekonomike. Unë kam filluar të punoj dhe marr një pagë 380 mijë lekë të vjetra për të ushqyer familjen prej 6 anëtarësh. Ne jemi të gatshëm të bëjmë kontratën me OSHEE dhe të shlyejmë gradualisht çdo muaj, përveç faturës mujore të energjisë, edhe pjesën e debisë në një vlerë 15–20 mijë lekë të vjetra në muaj. Kam vajzën me azëm dhe nuk kam energji të karikoj aparatit

<sup>2</sup> Ankesa nr. 271 Regj/2025.

<sup>3</sup> Ankesa nr. 272 Regj/2025.

<sup>4</sup> Ankesa nr. 273 Regj/2025.

<sup>5</sup> Ankesa nr. 274 Regj/2025

*për ta ndihmuar me frymëmarrjen, shkoj në lokale. Fëmijët nuk mund të mësojnë dhe as të lahen dhe as gatuaj. Bashkëshortja është me hernie diskale. Numri i kontratës është T-634174.”*

5. **Z. P.P<sup>6</sup>**: *“Jam kryefamiljar i ve, me një djalë minoren i cili vazhdon gjimnazin “Arben Broci”. Jam i sëmurë, banoj në banesë sociale. Jam në pension dhe marr një shumë prej 9.000 lekë të reja. Nga viti 2016 nuk kam paguar detyrimet e energjisë elektrike sepse nuk kam pasur asnjë mundësi financiare. Para dy javësh OSHEE Tiranë na ka ndërprerë lidhjen e energjisë elektrike. Unë jam burrë i ve, në moshë, pa grua, vetëm me një fëmijë që i duhet të ushqehet dhe të lahet. Prandaj kërkoj lidhje të energjisë elektrike nga OSHEE dhe bërjen e një marrëveshjeje me OSHEE për ta shlyer shumën gradualisht me këste në shumën 15–20 mijë lekë të vjetra në muaj, përveç faturës mujore. Numri i Kontratës është T-633996.”*
6. **Z. L.T<sup>7</sup>** (me Nr. Kontrate me OSHEE: TR2T120226634427): *“Jam kryefamiljar, jetoj me gruan dhe 2 fëmijët. Jam invalid dhe trajtohem me KEMP, rreth 19.000 lekë të reja. Bashkëshortja është pensioniste dhe merr 21.400 lekë të reja në muaj. Që prej vitit 2017 nuk kam mundur të paguaj energjinë elektrike. Jam debitor në shumën 728.038 lekë të reja. Kam shkuar pranë OSHEE-së për të bërë një Akt-Marrëveshje dhe më kanë thënë që kësti i parë është 141.000 lekë, por nuk kam mundur ti paguaj. Nëse bëhet një Akt-Marrëveshje mund të paguaj faturën e muajit dhe 1200 lekë të reja në muaj.”*
7. **Z. G.H<sup>8</sup>**: *“Jam kryefamiljar dhe jetoj me gruan dhe dy fëmijët. Jam invalid dhe trajtohem me KEMP, në shumën 8.700 lekë të reja në muaj. Bashkëshortja ka rreth dy muaj që ka filluar punë pranë shoqërisë Eco Tirana të Bashkisë Tiranë dhe paguhet 20.150 lekë të reja në muaj. Në vitin 2021 kam ndaluar së paguari energjinë elektrike, për shkak të pamundësisë ekonomike dhe jam debitor në shumën 438.277 lekë të reja. Jam interesuar pranë OSHEE dhe më kanë thënë të paguaj 200.000 lekë të reja për të bërë Akt-Marrëveshjen. Unë nuk kam mundësi të paguaj këtë shumë, por kërkoj të paguaj faturën e muajit dhe një shumë prej 1.500 lekë të reja në muaj. Kontrata nr: T-634449”.*
8. **Z. T.M<sup>9</sup>**: *“Jam kryefamiljar, jetoj me bashkëshorten, djalin, nusen e djalit dhe tre fëmijët. Kam gati pesë muaj që kam filluar punë në Eco Tirana pranë Bashkisë Tiranë, paguhem 40.000 lekë të reja në muaj dhe jam i vetmi i punësuar në familje. Bashkëshortja dhe unë nuk jemi në gjendje të mirë shëndetësore. Deri në vitin 2020 i kemi paguar aktualisht, jam debitor në shumën 700.000 lekë të reja, pasi jam interesuar pranë OSHEE, më kanë thënë të paguaj shumën 200.000 lekë të reja për të lidhur akt-marrëveshjen, por nuk kam mundësi të paguaj, pasi jemi në vështirësi. Mund të paguajë faturën e muajit dhe shumën 1500 lekë të reja në muaj. Numri i kontratës: 634423”*
9. **Znj. F.S<sup>10</sup>**: *“Jam kryefamiljare me statusin e të verbërit, trajtohem me KEMP në shumën 14.300 lekë të reja në muaj dhe djali im më është caktuar si shoqëruesi im. Kam ndaluar ta paguaj energjinë elektrike që në vitin 2017 dhe jam debitore në shumën 405.072 lekë të reja. Kemi më shumë se 7 ditë pa energji elektrike. Jam e gatshme të paguaj nëse më lidhet një akt*

---

<sup>6</sup>Ankesa nr. 275 Regj/2025.

<sup>7</sup>Ankesa nr. 277 Regj/2025.

<sup>8</sup>Ankesa nr. 278 Regj/2025

<sup>9</sup>Ankesa nr. 279 Regj/2025.

<sup>10</sup>Ankesa nr. 280 Regj/2025

*marrëveshje. Numri i Kontratës është T-634161. Kërkoj të më zgjidhet problematika e furnizimit me energji elektrike me akt marrëveshje.”*

- 10. Znj. F.R<sup>11</sup>:** *“Jetoj me tre fëmijët e mi. Unë jam e vetmja e punësuar në familje. Punoj tek EKO Tirana dhe paguhem 36.000 lekë në muaj. I përkasim komunitetit rom. Jam debitore tek OSHEE sha, në shumën prej 76.047 lekësh. Numri i Kontratës është 634397. Kemi 7 (shtatë) ditë që na është ndërprerë energjia elektrike. Nëse bëhet një Akt-Marrëveshje, kërkoj të paguaj faturën e muajit dhe shumën prej 1200 lekësh në muaj, pasi të ardhurat e mija financiare janë shumë të ulëta.”*
- 11. Znj. V.B<sup>12</sup>:** *“Jam kryefamiljare në moshën 70 vjeç, me aftësi të kufizuara dhe trajtohem me KEMP në shumën 11.652 lekë të reja në muaj. Nga pamundësia ekonomike që prej vitit 2018 nuk kam paguar energjinë elektrike. Nuk kam asnjë mundësi ekonomike të paguaj debitin dhe shumën mujore. Kontrata nr: T-634037”.*
- 12. Znj. Y.C<sup>13</sup>:** *“Jam pensioniste, jetoj me djalin dhe i përkasim komunitetit egjiptian. Djali është i papunë dhe të ardhurat familjare janë vetëm pensioni im në shumën 10 000 lekë të reja në muaj. Ka më shumë se 7 ditë pa energji elektrike. Në vitin 2017 kemi ndaluar së paguar energjinë elektrike dhe jemi debitor. Në rast se lidhet një kontratë jam e gatshme të paguajë faturën e muajit dhe 1200 lekë të reja në muaj. Numri i kontratës: 634012”*
- 13. Z. A.M<sup>14</sup>:** *“Jam kryefamiljar me aftësi të kufizuar, i përkasim komunitetit rom, jetoj me gruan dhe fëmijët. Ndaloja të paguari energjinë elektrike për shkak të pamundësive financiare. Gruaja është pa punë për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, gjithashtu fëmijët janë pa punë. Kemi disa ditë pa energji elektrike dhe jemi debitor në shumën 150.000 lekë të reja. Jam i gatshëm të lidh një akt marrëveshje ku të paguaj dhe faturën e muajit.”*
- 14. Znj. S.M<sup>15</sup>:** *“Jam kryefamiljare, bashkëshorti ka 5 (pesë) vite që ka ndërruar jetë. Jetoj me fëmijët e djalit dhe nusen e tij. Në familje jemi në vështirësi ekonomike, unë nuk kam pension dhe të ardhurat financiare janë të ulëta. Kemi 7 (shtatë) ditë që na është ndërprerë energjia elektrike. Nëse bëhet një Akt-Marrëveshje, kërkoj të paguaj faturën e muajit dhe shumën prej 1200 lekësh në muaj. Numri i Kontratës është 634176. ”*
- 15. Z. P.D<sup>16</sup>:** *“...Jetoj me bashkëshorten dhe 6 anëtarë të tjerë në familje. Djalin e vogël që quhet Reis, 10 vjeç, e kam të sëmurë me diagnozë: DIA-Cardiopati, Azëm Bronkide të formës së rëndë dhe Epilepsi Sekondare të pakontrolluar. Monitorohet me aparat oksigjeni 24 orë në ditë. Për këtë problem është në dijeni Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Avokati i Popullit dhe mediat. Unë kërkoj nga OSHEE të mos më ndërpritet energjia elektrike për shkak të rrezikut të djalit të vogël. Të bëhet një Akt-Marrëveshje me OSHEE-në që unë ti paguaj me këste dhe jo të gjitha menjëherë këtë shumë të konsiderueshme sepse jam me të ardhura 25.000 lekë të reja. ”*

<sup>11</sup> Ankesa nr. 281 Regj/2025.

<sup>12</sup> Ankesa me nr. 282 Regj/2025

<sup>13</sup> Ankesa nr. 283 Regj/2025

<sup>14</sup> Ankesa me nr. 284 Regj/2025

<sup>15</sup> Ankesa nr. 285 Regj/2025.

<sup>16</sup> Ankesa nr. 286 Regj/2025.

- 16. Znj. A.M, z. O.M<sup>17</sup>:** “Jetoj me bashkëshortin dhe tre fëmijët e mijë. Deri në vitin 2020 kam paguar rregullisht energjinë elektrike. Në datë 10.11.2025 më kanë ndërprerë energjinë elektrike. Vajzën 6 vjeçare e kam me probleme shëndetësore, me dy vrima në zemër dhe me sytë. Edhe një nga djemtë e kam me probleme me sytë. Unë kam katër muaj që kam filluar punë me 20.000 lekë të reja në muaj dhe jam me kontratë 1-vjeçare. Kjo pagesë nuk më del për të paguar shpenzimet mujore të vajzës. Pra jam në pamundësi ekonomike për të paguar faturën e dritave. Kontrata nr: T-634164”.
- 17. Z. A.I<sup>18</sup>:** “Unë A.I jetoj me bashkëshorten invalide dhe 2 fëmijët e mi minorene, 16 dhe 10 vjeç. Në datën 10.11.2025 na kanë ndërprerë dritat. Nusja është invalide dhe nuk lëviz fare që të ketë mundësi për të punuar. Unë jam i papunë dhe nuk kam të ardhura. Nusja në KEMP invaliditeti 86 mijë lekë të vjetra. Deri në mars 2020 kam paguar dritat sipas librezës. Numri i kontratës 634400.”
- 18. Znj. Th.A<sup>19</sup>:** “Mua më është ndërprerë energjia elektrike që me datë 10.11.2025. Për shkak të gjendjes sime shëndetësore unë marr vetëm një pagesë prej 10 000 lekësh në muaj. Jemi pa të ardhura dhe pa ndihmë ekonomike, e kemi të pamundur për të paguar, pasi burrë e grua jemi të papunë dhe nuk e kemi të mundur të realizojmë pagesën e energjisë. Jemi familje në nevojë. Numri i Kontratës është 634383. Kërkoj të më zgjidhet problematika e furnizimit me energji elektrike.”
- 19. Znj. A.L<sup>20</sup>** (me Nr. Kontrate me OSHEE: T1633970): “Jam banore e bllokut të Banesave Sociale Shkozë dhe kam një sërë problematikash që do ti rradhisi si më poshtë: Jam e sëmurë me tension, kam kryer 4 operime, marr ilaçe çdo muaj sipas recetës së mjekut. Problemi im kryesor është me dritat e shtëpisë. Më datë 10.11.2025 më kanë ndërprerë energjinë elektrike. Kam kaq ditë pa drita. Në shtëpi kam edhe bashkëshortin i cili është i sëmurë me zemër, tension dhe koronare. Është e pamundur të jetohet pa drita në ditë të ftohta dimri. Arsyeja e ndërprerjes së dritave është pamundësia për të paguar faturat. Kam paguar deri në vitin 2019 rregullisht. Kërkoj të më lidhen dritat. Ilaçet që marrim të dy kushtojnë shumë. Të bashkëshortit 8500 lekë të reja dhe të mijat 5500 lekë të reja”.
- 20. Z. A.M<sup>21</sup>:** “Unë jetoj i vetëm dhe në datë 10.11.2025 më kanë ndërprerë energjinë elektrike, sepse nuk kam mundësi ekonomike për ti paguar. Dua të bëj kontratë por nuk kam mundësi të paguaj shumën 250.000 lekë të reja. Kontrata nr: T-6314156”.
- 21. Znj. S.J<sup>22</sup>:** “Banojmë 8 persona në një familje. Nga të gjithë anëtarët e familjes unë punoj tek Eco Tirana, me të ardhura mujore 40 000 lekë të reja. Prej 10 ditësh më është ndërprerë energjia elektrike nga OSHEE për shkak se nuk i kam paguar për shkak të pamundësisë ekonomike. Kam nipin në banesë, i cili vuan nga azma dhe nevojitet që ai të trajtohet me oksigjen në shtëpi. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike nuk mund të vendos aparatit e oksigjenit në punë dhe nipi nuk trajtohet me oksigjen. Kam një detyrim prej rreth 300 000 lekë të reja. Kam rreth 2 vite që vetëm unë punoj në familje. Nuk kam patur ndonjëherë akt

17 Ankesa me nr. 287 Regj/2025

18 Ankesa nr. 288 Regj/2025

19 Ankesa nr. 290 Regj/2025

20 Ankesa nr. 291 Regj/2025

21 Ankesa me nr. 292 Regj/2025

22 Ankesa nr. 293 Regj/2025

*marrëveshje me OSHEE. Bie dakord që të lidh aktmarrëveshjen me OSHEE duke paguar faturën mujore dhe një shumë prej 1200 lekësh në muaj. Numri kontratës: 634261.”*

- 22. Znj. V.K<sup>23</sup>:** *“Jetojmë 4 persona në familje. Që prej vitit 2020 nuk kam paguar energjinë elektrike për shkak të pamundësisë financiare. Unë i përkas komunitetit egjiptian, kam djalin të sëmurë me tumor në kokë dhe vetë kam përfituar pagesën e invaliditetit deri para 2 vitesh. Më kanë ndërprerë KEMP-in prej 2 vitesh. Asnjë nga anëtarët e familjes nuk punon, jemi të gjithë pa punë. Kam detyrim rreth 400.000 mijë lekë të reja tek OSHEE por nuk kam mundësi t’i paguaj. Nuk kam pasur ndonjëherë akt marrëveshje me OSHEE. Aktualisht nuk kam mundësi të paguaj asnjë shumë pranë OSHEE pasi jemi të papunë dhe 2 prej anëtarëve të sëmurë. Të ardhurat e vetme ekonomike janë nga puna ime informale. Prej datës 13.11.2025 na është ndërprerë energjia elektrike. Numri i Kontratës është TR 2T120225634154.”*
- 23. Z. B.S<sup>24</sup>:** *“Jam posedues i kontratës së energjisë elektrike Nr. 634430. Prej vitit 2018, nuk kam paguar energjinë elektrike për shkak të kushteve ekonomike. Jetojmë 7 (shtatë) persona në një banesë: unë, bashkëshortja dhe 5 fëmijët tonë. Prej një jave OSHEE më ka ndërprerë furnizimin me energji elektrike. Për shkak se kam pasur djalin me azëm kronike, më është dashur ta kuroj dhe për këtë arsye nuk kam pasur mundësi të paguaj energjinë elektrike. Kam një debi prej 900.000 lekësh. Aktualisht punojmë unë dhe bashkëshortja, por nuk kemi mundësi të tilla financiare që të paguajmë të gjithë detyrimin njëherësh. Prandaj, kërkoj që të më rilidhet energjia elektrike, si dhe të lidh një Akt-Marrëveshje që të paguaj me këste detyrimin tim. Mund të paguaj maksimumi 5000 lekë në muaj, përveç faturës mujore. Kërkoj të merret parasysh kërkesa ime, duke vlerësuar mundësitë e mija financiare.”*
- 24. Z. J.N<sup>25</sup>:** *“Jemi 8 persona në familje, me bashkëshorten dhe 6 fëmijët dhe i përkas komunitetit rom. Asnjë prej nesh nuk punon dhe trajtoheni me ndihmë ekonomike, në shumën prej 19.500 lekë të reja në muaj. Prej më shumë se 8 vitesh nuk kam paguar energjinë elektrike, pasi nuk kam mundësi financiare. Nga data 13.11.2025 më kanë ndërprerë energjinë elektrike, për shkak se nuk i kam paguar. Aktualisht mund të lidh Akt-Marrëveshje me OSHEE duke paguar faturën e muajit, plus 1.500 lekë të reja në muaj. Kontrata nr: T-634160”.*
- 25. Znj. I.K<sup>26</sup>:** *“Banoj me djalin dhe bashkëshortin në një banesë. Banesa është në emër të babait të bashkëshortit i cili ka ndërruar jetë. Mamaja e bashkëshortit është larguar nga banesa dhe jeton diku tjetër. Kam djalin i cili përfiton pagesë invaliditeti pasi vuan nga epilepsia dhe tumori në veshka. të vetmet të ardhura familjare janë pagesa që përfiton djali nga KEMP prej 12 000 lekë të reja. ne i përkasim pakicës rome. Që prej vitit 2020 nuk e kemi paguar energjinë elektrike dhe për këtë arsye më datë 10.11.2025 më kanë ndërprerë energjinë elektrike. detyrimin e energjisë elektrike nuk e di. Aktualisht më kanë lidhur energjinë elektrike pasi u ankova tek Avokati i Popullit për shkak të gjendjes shëndetësore të djalit. Aktualisht nuk kam mundësi ekonomike të lidh aktmarrëveshje. Kontrata është në emër të vjehrrit z. Sh.K. Numri i kontratës: 634356 ”*

<sup>23</sup> Ankesa me nr. 294 Regj/2025

<sup>24</sup> Ankesa me nr. 295 Regj/2025

<sup>25</sup> Ankesa me nr. 296 Regj/2025

<sup>26</sup> Ankesa nr. 297 Regj/2025

26. **Znj. L.H<sup>27</sup>**: “*Jetoj e vetme në një banesë sociale që në vitin 2017. Nuk kam paguar energjinë asnjëherë pasi nuk kam pasur mundësi ekonomike. Prej 7–8 muajsh jam e papunë. Aktualisht sapo kam filluar punë në një biznes privat me pagesë minimale. Kam rreth 480.000 mijë lekë të reja detyrime të papaguara ndaj OSHEE-së dhe për këtë arsye më kanë ndërprerë energjinë elektrike. Aktualisht jam pa drita. Jam dakord të paguaj një faturë mujore prej 25 mijë lekë të vjetra plus faturës mujore pas akt-marrëveshjes. Kërkoj sipas këtyre kushteve të më lidhet akt marrëveshja. Numri i kontratës së OSHEE-së është T-634290.*”
27. **Znj. R.M<sup>28</sup> (me Nr. Kontrate me OSHEE: T-633928)**: “*...Jetoj me bashkëshortin, dy djemt, nipin dhe mbesën. Të gjithë jemi të papunë dhe i përkasim komunitetit rom. Kam rreth 1 vit e gjysëm pa energji elektrike. Kam ndalur së paguari në vitin 2018. Jam në dijeni që jam debitore në shumën 350.000 lekë të reja. Në rast se më jepet mundësia për të lidhur një Akt-Marrëveshje, jam dakord të paguaj faturën mujore të energjisë dhe debininë deri në 1200 lekë të reja në muaj., pasi jam në pamundësi ekonomike. Djali im, M.M, është me prapambetje mendore dhe nuk trajtohet me Kemp. Bashkëshorti, i cili është edhe kryefamiljari, është në gjendje jo të mirë shëndetësore*”.

Përfundimisht, ankuesit kërkojnë nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, sipas shkaqeve të pretenduara të diskriminimit nga ana e OSHEE sh.a., ndërhyrjen për rilidhjen e energjisë elektrike, si dhe mundësimin e lidhjes së një akt-marrëveshjeje me OSHEE për shlyerjen graduale të detyrimeve të prapambetura, me këste mujore të përbalueshme, krahas pagesës së faturës mujore,

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (në vijim LMD), që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesat e paraqitura janë në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe u pranuan për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara në nenin 33, pika 4, të këtij ligji.

<sup>27</sup> Ankesa me nr. 298 Regj/2025

<sup>28</sup> Ankesa nr. 304 Regj/2025

**Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjet dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Me shkresën nr. 1665/1 prot., datë 03.12.2025, nr. 1640/1 prot., datë 04.12.2025, nr. 1637/1, datë 09.12.2025, nr. 1657/1, datë 04.12.2025, nr. 1699/1 datë 04.12.2025, nr. 1639/1 prot datë 11.12.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, duke kërkuar informacion të detajuar në lidhje me ankesat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit, si dhe sqarime mbi procedurat e ndjekura për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe për detyrimeve të prapambetura nga ankuesit.
2. Duke marrë shkas se nuk u kthye asnjë përgjigje brenda afateve ligjore për shkresat e sipërcituara, me shkresat nr. 55 prot., datë 07.01.2026, nr. 51 prot., datë 07.01.2026 dhe nr. 117 prot., datë 13.01.2026, Komisioneri u ka dërguar rikujtesë Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., duke kërkuar përsëri dërgimin e informacionit të kërkuar.
3. Me shkresën nr. 6412/2 prot., datë 12.01.2026<sup>29</sup>, nr. 6571/2 prot., datë 13.02.2026, nr. 6390/1 prot., datë 12.01.2026<sup>30</sup>, nr. 6427/1 prot., datë 12.01.2026<sup>31</sup>, nr. 6498/1 prot., datë 12.01.2026, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., ka kthyer përgjigje, duke paraqitur informacion lidhur me situatën e ankuesve, masat e marra nga ana e shoqërisë, si dhe sqarime mbi procedurat e ndërprerjes së energjisë elektrike dhe kushtet për lidhjen e akt-marrëveshjeve, duke informuar se:

Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit rezulton që kontratat e energjisë elektrike me numrat e vënë në dispozicion dhe që furnizon ambientet e banuar nga familjet e palëve ankuese, janë me titullar Bashkia Tiranë dhe kanë debi ndaj FSHU sh.a.

Këto familje janë strehuar nga Bashkia Tiranë në banesat sociale dhe konsumojnë energji elektrike. Që nga momenti i çeljes së kontratave dhe marrjes nga Bashkia Tiranë për këto kontrata nuk janë likuiduar faturat mujore të konsumit. Kjo ka krijuar situatën debitore të tyre sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Kontrata	Vlera e debisë	Periudha e debisë
1.	N.Sh/V.Sh	TR2T120225634237	1,223,425.63	Shkurt 2018- Dhjetor 2025

<sup>29</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 51/1 prot., datë 14.01.2026.

<sup>30</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 55/2 prot., datë 14.01.2026.

<sup>31</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 55/3 prot., datë 14.01.2026.

2.	T.M	TR2T120225634423	949,760.68	Gusht 2018 – Dhjetor 2025
3.	Y.C	TR2T120224634012	367,044.41	Janar 2018- Dhjetor 2025
4.	A.I	TR2T120225634400	397,555.24	Shkurt 2020- Dhjetor 2025
5.	S.J	TR2T120225634261	581,879.24	Dhjetor 2019- Dhjetor 2025
6.	I.K	TR2T120225634356	1,383,780.19	Janar 2017- Dhjetor 2025
7.	R.M	TR2T120224633928	348,106.00	Maj 2018-Nëntor 2025
8.	I.N	TR2T120225634421	79,493.97	Shkurt 2020 - Nëntor 2025
9.	L.N	TR2T120225634240	1,313,097.19	Janar 2018 - Nëntor 2025
10.	G.H	TR2T120226634449	449,926.71	Janar 2020 - Nëntor 2025
11.	V.B	TR2T120224634037	1,335,455.20	Tetor 2018 - Nëntor 2025
12.	A.M	TR2T120225634164	610,517.85	Janar 2021 - Nëntor 2025
13.	A.M	TR2T120225634156	490,730.72	Shtator 2015 - Nëntor 2025
14.	J.N	TR2T120225634160	148,432.10	Nëntor 2015 - Nëntor 2025
15.	Familja C	TR2T120225634174	420,110.13	Qeshor 2021 - Nëntor 2025
16.	P.P	TR2T120224633996	727,413.43	Dhjetor 2016 - Nëntor 2025

17.	F.S	TR2T120226634161	409,445.66	AKM me këste 1200 lekë/muaj
18.	A.M	Nuk ka nr. kontrate		
19.	V.K	TR2T120225634154	810,078.90	Prill 2020 - Nëntor 2025
20.	L.H	TR2T120225634290	482,494,18	Dhjetor 2016 - Nëntor 2025

*FSHU sh.a. është një shoqëri tregtare e cila funksionon sipas dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Bazuar në këtë ligj, politikat e shoqërisë përcaktohen nga organet drejtuese të saj, ku faktori primar është arkëtimi i detyrimeve të prapambetura përmes krijimit të lehtësirave për shlyerjen e detyrimeve të klientëve të shoqërisë, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë.*

*Përfshirja në Akt Marrëveshje nënkupton krijimin e lehtësirave që Shoqëria FSHU sh.a. ofron për pagesën e detyrimeve të prapambetura për klientët debitorë të saj, përmes skemës së pagesës me këste, duke mos i bërë ata objekt të ndërprerjes së energjisë elektrike apo të procesit gjyqësor, si dhe duke krijuar mundësinë reale për arkëtimin e debive të prapambetura.*

*Me qëllim lehtësimin e mëtejshëm për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura, sikurse çdo vit, edhe gjatë vitit 2025 janë miratuar “Skemat për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura të Klientëve Debitorë” për të gjitha kategoritë e klientëve. Në këto skema janë parashikuar edhe kushtet specifike për t’u plotësuar nga klientët në mënyrë që të përfitojnë nga lehtësirat e krijuara.*

*Në skemën e Akt Marrëveshjes nuk përfshihen detyrimet e 2024-2025.*

*Në rastin kur konsumatori i energjisë elektrike i kontratës nuk është titullari apo përdoruesi i saj, nuk ekziston një lidhje ligjore, e cila do të lejojë lidhjen e AKM midis FSHU sh.a. dhe palës që kërkon të bëjë pagesën për faturat e prapambetura të energjisë elektrike. Kjo nuk do të thotë që personat të cilët nuk janë titullar të mos kryejnë pagesa për faturat e energjisë së këtyre kontratave, por jemi përballë një rasti moslegjitimitimi për lidhjen faktike të AKM-së.*

*Kontratat e furnizimit me energji elektrike të cilat janë objekt i kërkesës tuaj për informacion, rezultojnë se kanë titullar Bashkinë e Tiranës. Nga ky fakt rezulton se ankuesit pranë KMD-së nuk kanë legjitimitet për të hyrë në akt marrëveshje me FSHU sh.a.*

*Pra fillimisht familjet që pajisen me banesa sociale duhet të paraqiten në zyrat e Kujdesit Ndaj Klientit të FSHU sha dhe të paraqesin dokumentacionin e dhënë nga Bashkia Tiranë ku specifikohet banesa që kanë në përdorim. Në këtë mënyrë bëhen përdorues të kontratës së energjisë elektrike dhe mund të nënshkruajnë AKM me FSHU për detyrimet e prapambetura.*

*Çdo muaj më pas duhet të shlyejnë këstin e AKM dhe faturën e konsumit për muajin aktual.*

*Në lidhje me klasifikimin Klient në nevojë, referuar nenit 95, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me ERE dhe grupet e interesit, janë përgjegjëse për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*Pas paraqitjes së setit të dokumentacionit nga klientët e interesuar, ku ndër të tjera kërkohet edhe paraqitja e dokumentit të ndihmës ekonomike apo të statusit të veçantë, informacioni procesohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe pa asnjë formë diskriminimi.*

*Për sa më sipër, ankesat e kësaj natyre do të duheshin të depozitoheshin pranë organeve kompetente të cilat përpilojnë dhe miratojnë listën e klientëve në nevojë sipas legjislacionit.*

*Shoqëria FSHU sh.a. është e gatshme që me paraqitjen e këtyre listave të fillojë procedurat e trajtimit të klientëve në nevojë me lehtësirat e ofruara për këtë kategori sipas ligjit.*

*Në këtë kuptim, FSHU sh.a. trajton të gjithë klientët debitorë, ku bëjnë pjesë edhe klientët familjarë të kategorisë së ndihmës ekonomike, pensionistët kryefamiljarë, jetimët nën 25 vjeç, etj, të cilët shprehin vullnetin për të kryer pagesën e detyrimit me këste fikse, në mënyrë të njëjtë dhe pa preferenca, duke respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit”.*

*Ndërsa, sa i përket ankuesve: z. L.T, z. P.D dhe znj. A.L, FSHU sh.a., sqaroi se: “Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit nuk rezulton të ketë kontrata energjie elektrike... Duke parë adresën e tyre (Banesat Sociale Shkozë) kontratat duhet të jenë me titullar Bashkia Tiranë. Në qoftë se nuk kemi kodin e kontratës nuk mund të evidentojmë debinë...”.*

*Sa i përket subjekteve ankues: znj. S.M, z. B.S, znj. F.R dhe znj. Th.A, nuk u disponua përgjigje zyrtare nga ana e FSHU sha dhe OSHEE sha.*

- 4. Nga shqyrtimi i informacionit të dërguar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.a., rezultoi se banesat në të cilat jetojnë ankuesit janë banesa sociale në pronësi të Bashkisë Tiranë. Për këtë arsye, me shkresën nr. 188 prot., datë 21.01.2026, Komisioneri i është drejtuar Bashkisë Tiranë, duke kërkuar informacion mbi statusin e pronësisë së banesave sociale, marrëdhëniet kontraktore, si dhe çdo masë të marrë apo të parashikuar për trajtimin e situatës së familjeve në fjalë.*
- 5. Me shkresën nr. 3096/1 prot., datë 12.02.2026, Drejtorisë së Monitorimit të Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë, administruar pranë Komisionerit me nr. 188/1 prot., datë 16.02.2026, ka dërguar informacionin e kërkuar, duke sqaruar se:*

*Kompleksi i Banesave Sociale Shkozë është i pari kompleks rezidencial që menaxhohet dhe administrohet nga Bashkia e Tiranës, që prej vitit 2016. Duke qenë se strehimi i kategorive sociale në vështirësi, është ndër prioritetet e vazhdueshme të Bashkisë së Tiranës (duke marrë parasysh dhe zhvillimet e lëvizjeve demografike), ky fenomen është trajtuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve, nëpërmjet disa programeve sociale që aplikohen pranë këtij institucioni.*

*Programi i strehimit të banesave sociale me qira u aplikua dhe vijon: Në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 8548, datë 11.11.1999, për “Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë nr. 33, datë 18.11.2013 për “Menaxhimin e Banesave Sociale me Qira”, në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social”, në zonën e Shkozës, “ish-Fonderia Mekanike”, Rregullores së Brendshme, “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 18.12.2025 për “Sistemimin në Banesat Sociale me qira”, Shkozë të disa familjeve në nevojë.*

*Rrjedhimisht, prej të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga baza ligjore, funksionimi i programit “banesë sociale me qira”, rregullohet nëpërmjet një kontrate qiraje, që lidhet ndërmjet qytetarit përfitues dhe Bashkisë Tiranë (si pronar legjitim).*

*Lidhur me situatën e banorëve ankues, do të vlerësojmë statusin e gjithsecilit për të gjetur zgjidhje sa më të lehtësuara.*

6. Me shkresën nr. 5972/1 prot., datë 16.02.2026<sup>32</sup> Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, pranë Bashkisë Tiranë, i dërgon për kompetencë, Drejtorisë së Monitorimit të Punëve Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit, pranë Bashkisë Tiranë shkresën nr. 303 prot., datë 06.02.2026 të Komisionerit.
7. Me shkresën nr. 6988/1 prot., datë 18.02.2026<sup>33</sup> Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Bashkia Tiranë i dërgon për kompetencë, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit, pranë Bashkisë Tiranë shkresën nr. 303 prot., datë 06.02.2026 të Komisionerit. (E njëjta shkresë është dërguar dhe me shkresën nr. 6128/1 prot., datë 18.02.2026 të Drejtorisë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<sup>34</sup>).
8. Me shkresën nr. 731/1 prot., datë 19.02.2026<sup>35</sup> Drejtoria e Administrimit dhe Banesave Sociale, informon Komisionerin se:

---

<sup>32</sup>Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 393 prot., datë 19.02.2026.

<sup>33</sup>Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 391 prot., datë 19.02.2026.

<sup>34</sup>Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 391/1 prot., datë 20.02.2026.

<sup>35</sup>Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 408 prot., datë 23.02.2026.

*“Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike është administruar shkresa e ardhur nga Drejtoria e Monitorimit të Punëve Publike, Bashkia Tiranë, me nr. prot. 3096/1, datë 12.02.2026, protokolluar nga ana jonë me nr. 731, datë 16.02.2026, në lidhje me ankesat e shprehura nga disa përfitues të Banesave Sociale për furnizimin me energji elektrike. Nisur nga kjo situatë dhe për të garantuar një shqyrtim të plotë dhe të koordinuar të çështjes, ju bëjmë me dije se:*

*Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, ushtron detyrat e saj ligjore dhe funksionale në administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale në zonën e Shkozës, ish-"Fonderia Mek". Veprimtaria e saj kryhet në përputhje me Rregulloren e Brendshme "Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së DPOP", miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 1264/2024, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak për strehimin social. Drejtoria ka kompetencë ligjore dhe funksionale për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale, lidhjen dhe monitorimin e kontratave të qirasë, si dhe për sigurimin e respektimit të detyrimeve të përfituesve sipas Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për strehimin social" (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në fuqi. Çdo akomodim i familjeve brenda banesave sociale kryhet në përputhje me listat e përfituesve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe sipas kriterëve të përcaktuara në vendimet përkatëse. Sa i përket furnizimit me energji elektrike dhe pagesave të pashlyera ndaj operatorëve të shërbimeve të energjisë (OSHEE), Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike nuk i është dhënë asnjë kompetencë ligjore. Çdo çështje e tillë mbetet brenda juridiksionit të operatorëve të shërbimeve dhe të operatorëve përkatës, duke respektuar kontratat dhe marrëveshjet ekzistuese për furnizimin dhe pagesën e energjisë.*

*Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike ka detyrë të raportojë çdo situatë që mund të ndikojë në përdorimin e banesave nga përfituesit dhe të sigurojë që administrimi i banesave të kryhet në mënyrë transparente, të dokumentuar dhe në përputhje me normat ligjore. Çdo kërkesë apo shqetësim i parashtruar nga organet kompetente trajtohet sipas procedurave ligjore dhe normative, duke respektuar kompetencat e përcaktuara për administrimin e pasurive publike dhe strehimin social.*

*Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike vepron brenda kompetencave të saj ligjore, duke garantuar administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale sipas kontratave të lidhura dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndërsa çdo çështje që lidhet me furnizimin me energji elektrike ose obligimet e përfituesve ndaj operatorëve të shërbimeve mbetet jashtë juridiksionit të saj.*

9. Me shkresën nr. 828/1 prot., datë 24.02.2026<sup>36</sup> Drejtoria e Administrimit dhe Banesave Sociale, pranë bashkisë Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit, Bashkia Tiranë, e informon këtë të fundit se:

*Në zbatim të Rregullores së Brendshme "Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike", miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 1264/2024, Drejtoria e Administrimit të Banesave*

---

<sup>36</sup> Administruar për dijëni pranë institucionit të Komisionerit me nr. 329/2 prot., datë 26.02.2026

*Sociale ushtron funksionet dhe kompetencat e saj në fushën e administrimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të banesave sociale në zonën e Shkozës, ish-"Fonderia Mek", duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak Tiranë që rregullojnë programin e strehimit social.*

*Në përgjigje të shkresave të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit, pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. 6988, datë 18.02.2026 prot. nga ana jonë me nr. 828, datë 19.02.2026 dhe shkresës me nr. prot. 6128/1, datë 18.02.2026 prot. nga ana jonë me nr. 840, datë 20.02.2026, në lidhje me problematikat e ngritura mbi furnizimin me energji elektrike për banorët ankues të banesave sociale, sqarojmë si më poshtë:*

*Në lidhje me kërkesën për pjesëmarrje në seancë dëgjimore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Hetimit Administrativ të parashikuar për datën 24.02.2026, ora 10:00, ju informojmë se Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale nuk ka pasur dijeni paraprake mbi zhvillimin e kësaj seance. Shkresat përkatëse janë administruar pranë kësaj Drejtorie në datën 24.02.2026, ora 12:24, pra pas përfundimit të orarit të njoftuar të seancës dëgjimore, duke e bërë objektivisht të pamundur pjesëmarrjen tonë.*

*Sa i përket kompetencave funksionale dhe ligjore, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, në cilësinë e strukturës në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, ushtron përgjegjësitë për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale, si dhe për monitorimin dhe zbatimin e kontratave të qirasë. Në këtë kuadër, ajo verifikon respektimin e detyrimeve kontraktore nga ana e përfituesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për strehimin social, aktet nënligjore përkatëse dhe vendimet e organeve kompetente të vetëqeverisjes vendore.*

*Në lidhje me furnizimin me energji elektrike dhe detyrimet e papaguara ndaj operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE), sqarojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike nuk ka kompetencë ligjore për të ndërhyrë në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet përfituesve dhe operatorëve të shërbimeve publike. Marrëdhënia juridike për furnizimin me energji elektrike është një marrëdhënie kontraktore civile midis individit përfitues dhe operatorit përkatës, e cila rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nga kushtet e kontratës së furnizimit. Për rrjedhojë, çdo detyrim financiar i lindur nga konsumimi i energjisë elektrike, si dhe çdo masë administrative e ndërmarrë nga operatori për shkak të mospagesës, bie në juridiksionin e palëve kontraktuese dhe nuk përbën përgjegjësi institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike.*

*Në ushtrimin e funksioneve të saj, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike ka detyrimin të raportojë dhe të evidentojë çdo situatë që mund të ndikojë në përdorimin normal të banesave sociale, duke garantuar administrim transparent, të paanshëm dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit. Çdo kërkesë apo shqetësim i adresuar nga institucione të pavarura kushtetuese, përfshirë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, trajtohet me përgjegjësi institucionale dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara ligjërisht.*

*Në përfundim, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike vepron brenda kompetencave të saj ligjore për administrimin e banesave sociale, ndërsa çështjet e furnizimit me energji elektrike dhe detyrimet përkatëse nuk përfshihen në juridiksionin e saj.*

10. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore. Nëpërmjet shkresave nr. 303 prot., datë 06.02.2026, nr. 329 prot., datë 10.02.2026, nr. 332 prot., datë 11.02.2026, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 24.02.2026.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në seancë, morën pjesë ankesit: P.D, P.P, G.H dhe T.M. Ankesit u përfaqësuan gjatë seancës dëgjimore nga z. G.S, përfaqësues i Shoqatës Për Drejtësi Sociale, sipas deklarimit të bërë gjatë seancës dëgjimore.

Në seancë mori pjesë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), përfaqësuar me autorizim nga z. A.A dhe znj. E.A.

Bashkia Tiranë nuk mori pjesë edhe pse rezultoi se kishte marrë dijeni rregullisht për datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, palët e pranishme i qëndruan të njëjtave pretendime të paraqitura si në ankesë, ashtu edhe në komunikimet e mëparshme shkresore. Pala ankuese, ndër të tjera, bëri me dije se, pas paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit, si dhe falë angazhimit të Shoqatës për Drejtësi Sociale, furnizimi me energji elektrike ishte rikthyer në mënyrë të menjëhershme. Megjithatë, ankesit shprehën pasiguri lidhur me vijueshmërinë e këtij shërbimi, duke pretenduar se ndërprerjet e energjisë elektrike ndodhin në mënyrë periodike dhe pa njoftim paraprak, çka sjell pasoja të drejtpërdrejta në jetën e tyre të përditshme, përfshirë pamundësinë për ndriçim, si dhe vështirësi në përdorimin e pajisjeve jetike dhe, në raste të caktuara, edhe të aparaturave mjekësore.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) paraqiti sqarime lidhur me rolin dhe kompetencat institucionale të OSHEE-së dhe të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU), duke theksuar procedurat që duhet të ndiqen nga abonentët në rast ndërprerjeje të energjisë elektrike, përfshirë detyrimin për paraqitjen e ankesave pranë strukturave përkatëse menjëherë pas konstatimit të ndërprerjes. Gjithashtu, ai evidentoi problematikat që lidhen me statusin juridik të banesave sociale, duke theksuar se, për sa kohë këto prona janë në administrim të Bashkisë Tiranë dhe rezultojnë detyrime të papaguara, si dhe mungesë rakordimi për shkak të mungesës së kontratave aktive të qirasë midis bashkisë dhe banorëve, krijohen pengesa në formalizimin e marrëdhënies kontraktore për furnizimin me energji elektrike.

Në këtë kuadër, u theksua se është e domosdoshme që Bashkia Tiranë të pajisë banorët me dokumentacionin përkatës, mundësisht me vërtetime që konfirmojnë të dhënat e banorit, statusin e banesës sociale dhe elementët e nevojshëm për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike. Ky veprim do të mundësonte që këta banorë të lidhin kontrata si abonentë provizorë, duke krijuar kështu një bazë ligjore për furnizimin e rregullt me energji elektrike dhe përfshirjen e tyre në skemat përkatëse të faturimit dhe mbrojtjes si konsumatorë, deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të tyre juridik dhe kontraktor.

Përfaqësuesi i OSHEE-së gjithashtu informoi mbi lehtësitë dhe udhëzimet e fundit të miratuara nga institucioni për trajtimin e rasteve të ngjashme, përfshirë kategorinë e “klientëve në nevojë”, duke sqaruar kriteret dhe procedurat për përfitimin e trajtimit të diferencuar në funksion të mbrojtjes sociale dhe garantimit të aksesit në shërbimin bazë të energjisë elektrike.

11. Duke marrë shkas nga sa u parashtrua në seancën dëgjimore të datës 24.02.2026, si dhe nga informacionet, të rejat dhe sugjerimet e dhëna gjatë zhvillimit të saj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 528 prot., datë 10.03.2026, si vijon:

- Informacion të detajuar mbi statusin juridik të familjeve ankuese në raport me banesat sociale që kanë në përdorim dhe kontratat përkatëse të energjisë elektrike.
- Çfarë masash konkrete ka ndërmarrë ose kishte planifikuar të ndërmernte Bashkia Tiranë për të garantuar furnizimin me energji elektrike të familjeve vulnerabël të strehuara në banesa sociale, në bashkëpunim me FSHU sh.a.?
- Nëse ishin ndërmarrë masa individuale për secilin nga rastet e sipërcituara, duke marrë në konsideratë përbërjen familjare, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar dhe situatën ekonomike të ankuesve;
- A kishte parashikuar Bashkia Tiranë mekanizma mbështetës ose ndërmjetësues për familjet në nevojë, me qëllim shmangien e ndërprerjes së shërbimeve bazë, si energjia elektrike?
- A ishte njoftuar Bashkia Tiranë nga ana e FSHU sh.a. për ndërprerjen e energjisë elektrike për familjet e subjekteve ankues? Nëse po, cilat ishin masat e marra nga ana e strukturave të Bashkisë Tiranë për të njoftuar subjektet ankues për ndërprerjen e energjisë elektrike?
- A ishin paraqitur kërkesa nga ana e subjekteve ankues për regjistrimin e tyre si përdorues të kontratave të energjisë elektrike dhe arsytet pse kjo procedurë nuk rezulton të jetë përmbushur në rastet konkrete?

12. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 18.03.2026<sup>37</sup> të Drejtorisë së Përgjithshme e Objekteve Publike, pranë Bashkisë Tiranë, ktheu përgjigje, duke parashtruar si më poshtë:

*“Në zbatim të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike "Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Drejtorisë së*

---

<sup>37</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 528/1 prot., datë 24.03.2026.

*Përgjithshme të Objekteve Publike", miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 1264/2024, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ushtron kompetencat e saj në mënyrë të përcaktuar dhe të kufizuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke u fokusuar në administrimin e banesave sociale, mirëmbajtjen e objekteve dhe menaxhimin e marrëdhënieve juridike të përdorimit të banesave sociale.*

*Në këtë kuadër, theksohet se kjo drejtori nuk ushtron dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca mbi marrëdhëniet kontraktore që përfituesit e banesave sociale krijojnë me operatorët e shërbimeve publike, përfshirë furnizimin me energji elektrike, të cilat përbëjnë marrëdhënie juridike të pavarura dhe të drejtpërdrejta ndërmjet palëve përkatëse, të rregulluara nga legjislacioni specifik në fuqi.*

*Pavarësisht mungesës së kompetencës direkte në këtë fushë, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ka ndërmarrë masa konkrete në funksion të administrimit të situatës dhe shmangies së pasojave sociale, duke vepruar përtej detyrimeve të saj funksionale. Konkretisht, në datën 26.02.2026, në bashkëpunim me shoqatën "Drejtësi Sociale", është organizuar një takim me banorët e sipërcituar, gjatë të cilit janë informuar mbi detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktore me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe mbi detyrimin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.*

*Në vijim, janë ndërmarrë masa administrative ndihmëse për pajisjen e këtyre banorëve me vërtetime përkatëse, në të cilat pasqyrohen numrat e kontratave të furnizimit me energji elektrike sipas çdo përfituesi dhe njësie banimi, me qëllim lehtësimin e procedurave pranë operatorit përkatës. Nga informacioni i administruar, këto vërtetime janë depozituar pranë strukturave kompetente të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mundësuar lidhjen e akt-marrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe, për rrjedhojë, rivendosjen e furnizimit me energji elektrike.*

*Sa i përket kërkesave të paraqitura nga banorët ankues, për lidhjen e kontratave të furnizimit me energji elektrike në emrin e tyre, sqarohjmë se këto banesa janë pasuri publike në pronësi dhe administrim të Bashkisë Tiranë dhe përdoren mbi bazën e marrëdhënieve juridike të përkohshme, konkretisht kontratave të qirasë apo huapërdorjes. Në këto kushte, lidhja e marrëdhënieve të drejtpërdrejta kontraktore me operatorë të shërbimeve publike pa miratimin dhe dijeninë e entit administrues bie në kundërshtim me regjimin juridik të administrimit të pasurisë publike dhe me detyrimet kontraktore në fuqi.*

*Për rrjedhojë, çdo pretendim që synon të atribuojë përgjegjësi Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike për ndërprerjen apo mosfurnizimin me energji elektrike për personat e sipërcituar është i pabazuar në ligj dhe në fakt, pasi kjo çështje nuk bën pjesë në juridiksionin funksional të këtij institucioni, por përbën një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet përfituesve dhe operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike.*

*Në përfundim, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ka përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet e saj ligjore dhe ka ndërmarrë masa mbështetëse për menaxhimin e situatës në funksion të interesit publik dhe mbrojtjes sociale të përfituesve, pa tejkalluar kufijtë e kompetencave të saj. Çdo përgjegjësi për marrëdhëniet e furnizimit me energji elektrike dhe detyrimet financiare përkatëse mbetet ekskluzivisht në juridiksionin e palëve kontraktore përkatëse.”*

13. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi shqyrtoi tërësinë e ankesave të paraqitura, vendosi bashkimin e tyre në një vendimmarrje të vetme, bazuar në arsyet e mëposhtme faktike dhe juridike.

Nga pikëpamja faktike, rezultoi se të gjithë ankuesit ndodhen në të njëjtat rrethana materiale: janë banorë të banesave sociale në kompleksin Shkozë, janë debitorë ndaj FSHU sh.a. dhe u është ndërprerë furnizimi me energji elektrike si pasojë e drejtpërdrejtë e pamundësisë financiare për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj këtij operatori.

Shqyrtimi i thelbit të çdo ankese zbuloi se, pavarësisht ndryshimeve në rrethanat personale dhe familjare të secilit subjekt ankues, baza e përbashkët e pretendimeve është identike: gjendja ekonomike dhe pamundësia financiare si shkak i vetëm dhe vendimtar që i ka çuar ankuesit në situatën e ankimuar pranë Komisionerit. Shkaqet e tjera të diskriminimit të pretenduara në ankesat individuale, si gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, gjendja familjare, gjendja civile apo raca, janë faktorë që shtojnë vulnerabilitetin e çdo ankuesi dhe vështirësojnë ndjeshëm mundësinë e tyre për t'i përballuar pasojat e ndërprerjes së energjisë elektrike, por nuk përbëjnë shkakun e trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që kundërshtohet në ankesat e ankuesve.

Nga pikëpamja juridike, Komisioneri ka parasysht se bashkimi i çështjeve në një vendimmarrje të vetme është i justifikuar kur ankesat kanë të njëjtin subjekt pasiv, të njëjtat rrethana juridike dhe faktike, të njëjtin shkak diskriminimi dhe pretendojnë të njëjtin lloj trajtimi të padrejtë.

Në rastin konkret, të gjitha këto kushte plotësohen njëkohësisht: subjektet pasive janë të njëjta, FSHU sh.a, OSHEE sh.a dhe Bashkia Tiranë; rrethanat juridike dhe faktike janë substancialisht të njëjta; shkakun e pretenduar i diskriminimit është i përbashkët gjendja ekonomike; dhe trajtimi i ankimuar është i njëjtë, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike si pasojë e mospagesës së detyrimeve të prapambetura. Bashkimi i ankesave garanton koherencën e vlerësimit juridik, shmang kundërthëniet e mundshme në arsyetim dhe siguron trajtim të barabartë e të unifikuar të situatave substancialisht të njëjta, në përputhje me parimet e ekonomisë procedurale dhe të sigurisë juridike.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë**

Nga faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjeve rezultoi se, ankuesit dhe familjet e tyre jetojnë në banesat sociale në Shkozë, të administruar nga Bashkia Tiranë, në kompleksin e Banesave Sociale në Shkozë.

Në muajin nëntor 2025 ankuesve dhe familjeve të tyre iu është ndërprerë furnizimi me energji elektrike për shkak se kanë rezultuar debitor dhe nuk kanë kryer pagesat për faturat e energjisë elektrike. Rezulton se gjatë shqyrtimit të ankesës ankuesve iu është rilidhur energjia elektrike. Nga provat dhe informacioni i administruar rezulton se, ankuesit dhe familjet e tyre ndodhen në një situatë vulnerabiliteti ekonomik dhe social. Shumica e ankuesve i përket pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane.

Disa prej familjeve ankuese kanë fëmijë të cilët duhet të ndjekin arsimin. Në disa prej familjeve të subjekteve ankuese ka persona me aftësi të kufizuara, përfshi edhe fëmijë me aftësi të kufizuara. Në disa raste, për shkak të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, furnizimi me energji elektrike paraqitet jetik për këta fëmijë pasi shëndeti i tyre është i lidhur me funksionimin e pajisjeve mjekësore që për të funksionuar kanë nevojë për energji elektrike. Të gjithë ankuesit kanë burime financiare të pamjaftueshme për të përballuar standardin minimal të jetesës dhe njëkohësisht për të shlyer detyrime të prapambetura ndaj operatorit të energjisë elektrike.

Gjatë shqyrtimit rezultoi se, ndërprerja e energjisë elektrike është një veprim i përsëritur pasi ka ndodhur edhe në raste të tjera që operatori i furnizimit me energji elektrike iu ka ndërprerë energjinë elektrike dhe e ka rilidhur sërish atë, pavarësisht se nuk ishin shlyer detyrimet e prapambetura. Gjatë seancës dëgjimore të datës 24.02.2026, ankuesit deklaruan se, edhe pas rikthimit të furnizimit me energji elektrike që u arrit si rezultat i ndërhyrjes së Komisionerit dhe Shoqatës për Drejtësi Sociale, ndërprerjet ndodhin në mënyrë periodike dhe pa njoftim paraprak, duke e bërë situatën strukturalisht të pazgjidhur dhe duke ruajtur pasigurinë e familjes lidhur me vijueshmërinë e shërbimit.

Nga faktet dhe provat e grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes rezultoi se, kontratat e furnizimit me energji elektrike për banesat sociale të kompleksit Shkozë, janë me titullar Bashkinë e Tiranës dhe jo familjet që banojnë në këto banesa. Të gjithë subjektet ankuese kanë debi të akumuluar në vlera të ndryshme, sikurse pasqyrohet në informacionin e vendosur në dispozicion nga FSHU sh.a dhe se e kanë të pamundur që të shlyejnë jo vetëm të gjithë detyrimin por edhe shumat që iu janë kërkuar nga ana e operatorit.

Kjo strukturë kontraktore ka sjellë si pasojë juridike të drejtpërdrejtë pamundësinë e ankuesve dhe familjeve të tyre për të lidhur akt-marrëveshje me Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU sh.a) për shlyerjen graduale të detyrimeve të prapambetura, edhe pse subjektet ankuese kanë shprehur gatishmëri për të shlyer detyrimet me këste mujore të përballueshme sipas gjendjes së tyre ekonomike. FSHU sh.a konfirmoi se ankuesit nuk kanë legjitimitet për të hyrë në akt-marrëveshje, duke arsyetuar se, për sa kohë titullari i kontratës është Bashkia e Tiranës, çdo marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve duhet të kalojë nëpërmjet bashkisë.

Ky bllok i dyfishtë dhe i ndërsjellët pamundësia ekonomike për shlyerjen e menjëhershme të detyrimeve nga njëra anë, dhe pengesa juridike për lidhjen e akt-marrëveshjes nga ana tjetër ka krijuar një situatë pamundësie nga e cila familja ankuese nuk mund të dalë me mjetet dhe mundësitë e veta. Vullneti i shprehur për shlyerje graduale dhe të rregullt të detyrimeve nuk gjeti rrugë ligjore zbatimi, jo për shkak të mungesës së gatishmërisë nga ana ankuesve, por si pasojë e strukturës institucionale dhe kontraktore të krijuar midis Bashkisë Tiranë dhe operatorit të shërbimit.

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se, Bashkia Tiranë, në cilësinë e titullarit të kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe si entitet përgjegjës për administrimin e banesave sociale, nuk ka ndërmarrë masa proaktive dhe të mjaftueshme për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të familjeve të strehuara në kompleksin Shkozë.

Nga provat e grumbulluara rezultoi se, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale pranë Bashkisë Tiranë ka pranuar shprehimisht se nuk ka kompetencë direkte për marrëdhëniet kontraktore të furnizimit me energji elektrike, duke e trajtuar këtë çështje si jashtë juridiksionit të saj. Ndërhyrja e saj ka ardhur vetëm pas presionit institucional të Komisionerit dhe ka pasur karakter reaktiv e jo proaktiv: organizimi i një takimi me banorët në datën 26.02.2026, pajisja e tyre me vërtetime për lehtësimin e procedurave pranë OSHEE-së dhe ndërmjetësimi administrativ për lidhjen e akt-marrëveshjeve. Këto masa, edhe pse të dobishme, janë ndërmarrë me vonesë dhe nuk adresojnë problemin strukturor.

Nga faktet e konstatuara gjatë shqyrtimit të çështjes rezultoi se, asnjë nga strukturat e Bashkisë Tiranë nuk kishte njoftuar familjet paraprakisht për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe as nuk kishte bashkërenduar me FSHU sh.a për të shmangur ndërprerjen e energjisë ndaj familjeve. Gjithashtu, nuk ka rezultuar e provuar se Bashkia Tiranë ka ndërmarrë hapa konkretë për të shlyer detyrimet e prapambetura të kontratave të cilat janë në emrin e saj, çka ka kontribuar drejtpërdrejt në ruajtjen e situatës debitore dhe, si rrjedhojë, në vazhdimësinë e ndërprerjeve periodike të shërbimit.

Nga tërësia e fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se subjektet ankuese janë vendosur në kushte të pafavorshme dhe jo të barabarta krahasuar me konsumatorë të tjerë të energjisë elektrike, të cilët, duke gëzuar kontrata të drejtpërdrejta dhe të rregullta me operatorin e shërbimit, kanë pasur mundësinë reale për të ushtruar të drejtat e tyre si konsumatorë përfshirë të drejtën për të lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen graduale të detyrimeve, si dhe për të gëzuar furnizim të pandërprerë me shërbimin bazë të energjisë elektrike.

Trajtimi i pafavorshëm i subjekteve ankuese dhe familjeve të tyre nuk buron nga vullneti diskriminues i shprehur nga ndonjëra prej palëve institucionale të përfshira në çështje. Ai buron nga zbatimi mekanik i rregullave administrative dhe procedurave kontraktore, pa marrë parasysh gjendjen e veçantë ekonomike dhe sociale të këtyre familjeve dhe pa ndërhyrë me mekanizma të

diferencuar mbrojtës për këto kategori familjesh që janë në kushte të vështira sociale dhe ekonomike. Pikërisht ky zbatim uniform ndaj rrethanave specifike të subjekteve ankues ka prodhuar, në efekt, një trajtim të pabarabartë dhe të pafavorshëm, i cili ka sjellë privimin e subjekteve ankues dhe familjeve të tyre nga aksesimi në një shërbim bazë dhe thelbësor, siç është energjia elektrike.

Furnizimi me energji elektrike dhe të drejtat dhe detyrimet midis ankuesit dhe FSHU sh.a rregullohen bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 43/2015) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. FSHU sh.a, kundër të cilës është paraqitur ankesa, është një shoqëri aksionere, e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. FSHU sh.a ushtron veprimtarinë e saj në sektorin e energjisë elektrike dhe ka si objekt të aktivitetit të saj tregtar, furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. FSHU sh.a, ofron furnizimin me energji elektrike, e ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik. Shërbimi universal i furnizimit si detyrim i shërbimit publik, përkufizohet nga ligji i sipërcituar, si vijon:

Neni 3, pika 76, e ligjit nr. 43/2015 parashikon: *“Shërbim universal i furnizimit” është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.”*

Neni 3, pika 10, i ligjit nr. 43/2015 parashikon: *“Detyrimi i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, efikasitetin e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.”*

Në rastin objekt shqyrtimi kemi të bëjmë me një kontratë të furnizimit të energjisë elektrike të lidhur me klientë familjar, i cili referuar nenit 3, pika 25, të ligjit nr. 43/2015, është një klient që blen energjinë elektrike vetëm për konsumin e tij familjar.

Neni 91, i ligjit nr. 43/2015 përcakton se: *“Klienti fundor i energjisë elektrike është i detyruar të paguajë detyrimet e energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të kontratës së furnizimit. Nëse klienti nuk paguan detyrimin e energjisë elektrike, furnizuesi i energjisë elektrike, i ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik, njofton me shkrim klientin për masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit, sipas përcaktimeve të kontratës dhe/ose të këtij ligji”*. Neni 92, pika “a” e ligjit të sipërcituar, përcakton se: *“Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar furnizuesi, në përputhje me parashikimet e kontratës, merr masat e mëposhtme: a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike”*.

Sa më sipër, rezulton se, në rast se klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike, furnizuesit të energjisë elektrike i lind e drejta që të procedojë me ndërprerjen e energjisë elektrike. Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes në shqyrtim, rezulton e provuar dhe e pranuar edhe nga subjektet ankuese, se këta të fundit nuk kanë shlyer detyrimet e energjisë elektrike dhe kanë debi të prapambetura të akumuluar. Në pamje të parë FSHU sh.a ka zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë, duke ndërprerë energjinë elektrike për subjektet ankuese, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet e energjisë elektrike, sikurse vepron për çdo klient i cili rezulton debitor ndaj shoqërisë.

Megjithatë, ligji nr. 43/2015, parashikon një kategori të veçantë klientësh, për të cilët për shkak të gjendjes së tyre sociale gëzojnë disa të drejta të veçanta në lidhje me furnizimin me energji elektrike. Këtë kategori klientësh, ligji e përkufizon në nenin 3, pika 30 të tij, duke parashikuar shprehimisht : “30. *“Klient në nevojë” është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.*”. Neni 84, pika 2, germa “d” e ligjit nr. 43/2015, sanksionon gjithashtu se: “2. *Furnizuesi universal, përveç kushteve të kontratës, të parashikuara në nenin 80, të këtij ligji, duhet: d) të furnizojë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 96 të këtij ligji.*”

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, e ka rregulluar situatën e posaçme të kategorisë së klientëve në nevojë në nenet përkatëse 95 e 96 të tij.

Kështu, neni 95, përcakton se: “1. *Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, harton kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.* 2. *Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë: a) klientët me të ardhura më të ulëta, të cilët e përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit tyre të përhershëm; b) klientët që kanë konsum të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin njëfazor me një fuqi maksimale prej 16 amper; c) nivelin maksimal të konsumit të energjisë për person, në varësi të sezonit; ç) mënyrën e përkrahjes së drejtpërdrejtë nga Buxheti i Shtetit.* 3. *Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike.* 4. *Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, duhet të përdorin fondet e përfituara për të paguar detyrimet e energjisë elektrike.* 5. *Financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike.* 6. *Nëse për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale e heq nga regjistri i klientëve në nevojë dhe njofton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesin. Të dhënat e klientit të hequr nga regjistri i klientëve në nevojë duhet të ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh pas 52 çregjistrimit.* 7. *Mbi bazën e të dhënave të përcjella, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi krijojnë dhe ruajnë një regjistër të të dhënave të klientëve në nevojë. Të dhënat e regjistrimit mund t’i vihen në dispozicion klientit në nevojë, në çdo kohë që kërkohen nga ky i fundit.”.*

Neni 96 , parashikon se: “1. Klientët familjarë, të cilët kanë përfituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji. 2. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë fillon në ditën që klienti regjistrohet prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqet informacion për furnizuesit e shërbimit universal për klientët në nevojë, brenda 5 ditëve nga regjistrimi i tyre. 3. Furnizuesi i klientit në nevojë i paraqet këtij të fundit kontratën dhe e informon rreth të drejtave dhe kushteve të furnizimit nën shërbimin universal. 4. Klienti në nevojë furnizohet me energji elektrike sipas tarifave të miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 85 të këtij ligji. 5. Furnizuesi, që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE. 6. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë përfundon në fund të muajit të dytë, nga momenti i çregjistrimit të klientit si klient në nevojë prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dërgon informacion te furnizuesi për klientët e çregjistruar, sipas njoftimit për daljen nga kategoria e klientit në nevojë, në fund të çdo muaji.”.

Sa më sipër, ligji është kujdesuar që të trajtojë në mënyrë të diferencuar të gjithë ata persona të cilët për shkak të të ardhura të ulëta, janë në pamundësi për të mbuluar nevojat e tyre për energji elektrike.

Në referim të nenit 108, të ligjit nr. 43/2015, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka patur detyrimin që të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 95/1, pra të miratojë procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Ligji nr. 43/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28.05.2015 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Akti nënligjor duhet të ishte miratuar nga Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra brenda datës 15.06.2016.

Neni 96/5, i ligji nr. 43/2015, vendos detyrimin se, furnizuesi që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin vetëm bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE. Në përmbushje të këtij detyrimi, me Vendimin nr. 246, datë 11.12.2018 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë është miratuar Rregullorja “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë” (në vijim Rregullorja e ERE-s). Bazuar në parashikimet e kësaj rregulloreje, Furnizuesi i Shërbimit Universal, ka një sërë detyrimesh, ku ndër të tjera:

- Furnizuesi duhet të vendosë sisteme/procese që sigurojnë se ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për klientët, të cilët gëzojnë statusin e “klientit në nevojë” dhe janë të regjistruar si të tillë, do të bëhet bazuar në kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për këtë kategori klientësh.
- Klientëve në nevojë të regjistruar, sipas kriterëve specifike, si të varur në mënyrë kritike nga energjia elektrike për jetën e tyre, nuk mund tu ndërpritet furnizimi me energji për shkak të mos pagesës së faturave të energjisë elektrike.
- Furnizuesi i energjisë elektrike nuk mund të ndërpresë furnizimin për mospagesë kur një klient përfiton nga statusi i “klientit në nevojë”, përveç se kur në 12 muajt e mëparshëm, ofruesi i

shërbimit (furnizuesi), i ka ofruar dy herë një plan pagese që përshtatet me të ardhurat e klientit ose asistencë pagese, në kuadër të statusit si “klient në nevojë” dhe është refuzuar nga klienti në nevojë.

- Furnizimi me energji elektrike nuk mund të ndërpritet në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t’u klasifikuar si “klient në nevojë”.
- Kur klienti ose një prej familjarëve të tij përdorin pajisje për mbështetjen e jetës të cilat funksionojnë me energji elektrike dhe ka njoftuar paraprakisht me shkrim për këtë situatë Furnizuesin Universal.
- Nuk mund të ndërpritet furnizimi me energji elektrike në ditët kur Furnizuesi nuk realizon shërbim për klientët në Qendrat e Kujdesit Ndaj Klientit (KNK), ose : a) Kur Klienti është duke respektuar një plan pagese formale. b) Kur Klienti ka paraqitur një ankesë, pranë KNK-ve ose zyrave të ERE-s, lidhur me shërbimin e furnizimit universal.
- Pavarësisht nga sa më lart, furnizimi i energjisë elektrike për klientët në nevojë, nuk mund të ndërpritet edhe në rastet e mëposhtme:
  - o Kur një Klient në nevojë i energjisë elektrike nuk paguan për furnizimin me energji elektrike plotësisht ose pjesërisht, sikurse kërkohet në kontratën e energjisë elektrike, por detyrimi i tij i përgjithshëm ndaj furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nuk e tejkalon nivelin minimal të të ardhurave, ose
  - o Në fundjavë ose gjatë ditëve të pushimit, sikurse dhe në rastet e kushteve atmosferike me temperaturë ditore – 15 gradë celcius.

Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për klientët në nevojë, mund të bëhet vetëm në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara nga Rregullorja e ERE-s.

Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018 janë miratuar “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”<sup>38</sup> Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, në nenin 6, pika 6.1.3 parashikohet: “Furnizimi me energji elektrike i klientëve që kanë përfituar statusin e “klientëve në nevojë”, do të ndërpritet vetëm sipas kushteve të parashikuara në Rregulloren e miratuar nga ERE, sipas nenit 95 të Ligjit Nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Ligji nr. 43/2015, është përafuar plotësisht me Direktivën 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike. Në nenin 7 të kësaj Direktive, parashikohet se: “Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cenueshëm, i cili do t’i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike”. Neni 8, i po kësaj Direktive parashikon se: “Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit

<sup>38</sup> [https://www.ere.gov.al/doc/Kontrata\\_universal\\_final\\_28\\_3\\_18.pdf](https://www.ere.gov.al/doc/Kontrata_universal_final_28_3_18.pdf)

*social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cenueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë... ”.*

Referuar situatës së subjekteve ankuese, Komisioneri konstaton se, të gjithë subjektet ankues janë të strehuar nga Bashkia Tiranë në kompleksin e banesave sociale të ndodhura në Shkozë, Tiranë, të cilat janë në administrimin e Bashkisë Tiranë. Ankuesit janë strehuar në këto banesa në momente të ndryshme por nuk ka informacion të saktë për momentin konkret se kur është strehuar secila nga familjet. Megjithatë rezultoi se, që nga momenti i strehimit të subjekteve ankuese dhe familjeve të tyre në këto banesa sociale, ku disa nga subjektet ankuese rezultoi se janë strehuar në këto banesa që prej vitit 2016, nuk rezultoi që të jetë ndërmarrë asnjë masë për të rinovuar kontratën e qirasë sociale dhe nuk është bërë asnjë vlerësim i situatës social-ekonomike të këtyre familjeve.

Kompleksi i banesave sociale në Shkozë, Bashkia Tiranë, është pjesë e fondit publik të banesave sociale, në administrimin e Bashkisë Tiranë dhe rregullohet në bazë të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. (në vijim ligji nr. 22/2018).

Sipas nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, pikat 5 dhe 6, parashikohet: “5. “Banesë sociale” është tërësia e banesave të përfituara sipas programeve sociale të parashikuara nga ky ligj. 6. “Banesë sociale me qira” është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.”

Subjektet ankuese dhe familjet e tyre janë strehuar në banesat sociale në Shkozë nga ana e Bashkisë Tiranë në kuadër të programeve të strehimit social sipas ligjit nr. 22/2018. Referuar nenit 2, pika 29, të këtij ligji përcaktohet se: “29. *“Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.”*

Baza për strehimin në një nga programet e strehimit social është në radhë të parë që familja të jetë e pastrehë dhe që të jetë pa të ardhura.

Në nenin 3, të ligjit nr. 22/2018, ku parashikohet parimi përballueshmërisë së strehimit, sanksionohet se: “1. *Strehimi konsiderohet i përballueshëm nëse familja me të ardhura: a) mesatare nuk shpenzon më shumë se 25 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm; b) të ulëta nuk shpenzon më shumë se 20 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm; c) shumë të ulëta nuk shpenzon më shumë se 15 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm.* 2. Në shpenzimet për strehimin nuk përfshihen shpenzimet për shërbime të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike. 3. Strehimi i

*familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërës prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.”*

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 22/2018, programi i banesave sociale me qira, është një nga llojet e programeve të strehimit social .

Neni 13, i ligjit nr. 22/2018, në pikat 1 dhe 2, përcakton kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit. Në pikën 3, të po kësaj dispozite, përcaktohet se, parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

Në këto kushte fakti që subjektet ankuese janë strehuar në banesat sociale në Shkozë në kuadër të programit të strehimit social të banesave sociale me qira, provon se ankuesit dhe familjet e tyre janë në kushtet e mungesës së të ardhurave ose të të ardhurave të pamjaftueshme. Në këto kushte, të gjithë subjektet ankuese e kanë të pamundur që të shlyejnë të gjithë vlerën e detyrimit të akumuluar, sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga FSHU sh.a.

Aktualisht janë në fuqi disa masa për lehtësimin e kategorive të ndryshme në nevojë si: familjet me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët me aftësi të kufizuara, pensionistët, invalidët dhe buxhetorët me pagë nën 35 000 lekë në muaj, të cilat përfitojnë kompensim të energjisë në zbatim të akteve: VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar; VKM nr. 404, datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, për personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”; VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj”.

Aktet nënligjore në fuqi për mbrojtjen e shtresave në nevojë, parashikojnë mbështetje për kategoritë e mësipërme, mbështetje kjo që është në formën e kompensimit financiar për energjinë elektrike. Të gjitha këto akte nënligjore, kanë dalë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Në momentin e miratimit të këtij ligji, ato janë vlerësuar si të pamjaftueshme për të mbrojtur shtresat në nevojë, pasi ligji ka parashikuar masa të tjera mbrojtëse sipas neneve 95 e 96 të këtij ligji. Dispozitat e ligjit nr. 43/2015, ofrojnë masa mbrojtëse sikurse është garantimi i të drejtës për t’u furnizuar me energji elektrike dhe ndërprerjen e energjisë elektrike vetëm në kushte specifike dhe rrethana të mirëpërcaktuara, duke ndaluar ndërprerjen e energjisë elektrike për shkak të pamundësisë për të paguar faturat e energjisë elektrike, për kategorinë e klientëve në nevojë, gjatë periudhës që ata gëzojnë këtë status të veçantë.

Përfitimet që rrjedhin nga skemat e kompensimit të energjisë elektrike për mbrojtjen e shtresave në nevojë, janë mbi bazën e kërkesës dhe jo automatikisht të aplikueshme për kategoritë përfituese.

Për të materializuar të drejtën që ligji ka garantuar për personat me të ardhura të ulëta, pra për ata që ligji i emërton “klientë në nevojë”, ligji ka parashikuar nxjerrjen e një akti nënligjor, i cili do të

përcaktojë modalitetet dhe procedurat, i cili do t'u mundësonte individëve dhe familjeve me të ardhura të ulta që të përfitonin nga kjo e drejtë ligjore.

Përpos detyrimit të vendosur nga neni 95/1, i ligjit nr. 43/2015 mbi MSHMS, e cila është ministria përgjegjëse për çështjet sociale, për hartimin e kritereve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, ligji, ka autorizuar dhe ka ngarkuar me detyrimin për miratimin e aktit nënligjor, që do t'i mundësonte klientëve në nevojë përfitimin e të drejtave të veçanta të garantuara nga ligji, Këshillin e Ministrave.

Sipas nenit 108, të ligjit nr. 43/2015, ky detyrim duhet të ishte përmbushur nga Këshilli i Ministrave brenda datës 15.6.2016, ndërkohë që akti nënligjor nuk është miratuar ende. Komisioneri, ka trajtuar më herët situatën e ndërprerjes së energjisë elektrike për kategori klientësh të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, kanë qenë në pamundësi financiare për të përballuar dhe për të paguar detyrimin e energjisë elektrike. Me vendimet nr. 92 dhe nr. 97, datë 05.04.2018, Komisioneri ka konstatuar situatën diskriminuese të shkaktuar si pasojë e mos hartimit të kritereve, procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, nga ana e MSHMS. Pavarësisht se, më herët Komisioneri ka konstatuar përgjegjësinë e MSHMS për mos hartimin e kritereve dhe procedurave për trajtimin e klientëve në nevojë, Këshilli i Ministrave në cilësinë e institucionit epror dhe të ngarkuar nga ligji për miratimin e aktit nënligjor, nuk ka marrë asnjë masë për të rregulluar situatën.

Faktet dhe rrethanat në çështjen objekt shqyrtimi, janë të ndryshme nga dy vendimet e mësipërme të Komisionerit. Vendimet e mësipërme të Komisionerit janë marrë në kushtet kur ERE, nuk kishte miratuar vendimin nr. 246, datë 11.12.2018 për miratimin e rregullores “*Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë*”, e cila lejon ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë, vetëm në kushtet specifike të përcaktuara në këtë rregullore.

Kriteret thelbësore për të përfituar statusin si “klient në nevojë” përcaktohen nga vetë ligji dhe një ndër to, janë të ardhurat e ulta të klientit. Ligji nuk ka përcaktuar sa është vlera e të ardhurave, në mënyrë që një klient të konsiderohet në nevojë.

Komisioneri vlerëson se, sa më sipër tregon qartë vulnerabilitetin e subjekteve ankues si konsumator të energjisë elektrike, të cilët për shkak të mungesës së të ardhurave ose të ardhurave të pamjaftueshme janë të strehuar nga Bashkia Tiranë në banesat sociale të Shkozës. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues dhe familjet e tyre vlerësohen si klientë me të ardhura të ulëta dhe për rrjedhojë mund të pretendojnë të drejtat e veçanta që ligji garanton për kategorinë e “klientit në nevojë”.

Kriteri thelbësor për të përfituar nga të drejtat e veçanta të parashikuara nga ligji për furnizimin me energji elektrike për kategorinë e klientit në nevojë, janë të ardhurat e ulta dhe bazuar në sa më sipër është arsyetuar, ankuesit mund të pretendojnë të drejtat e veçanta që ligji garanton për kategorinë e “klientit në nevojë”. Pavarësisht mungesës së hartimit dhe miratimit të aktit nënligjor për “klientin në nevojë”, sipas parashikimit të nenit 95/1, të ligjit nr. 43/2015, ERE ka përmbushur detyrimin e saj duke përcaktuar kushtet specifike mbi bazën e të cilave furnizuesi i energjisë

elektrike që furnizon klientët në nevojë, mund të bëjë ndërprerjen e energjisë elektrike për këtë kategori të veçantë klientësh. Në nenin 2, të Rregullores së ERE-së, përcaktohet: *“Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë dhe sigurojë, rregulla të qarta për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike, nga Furnizuesi për Klientët në Nevojë në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe në këtë rregullore, si dhe të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve në nevojë, në respekt të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga statusi i tyre.”*

Në situatën kur ankuesit rezultojnë përfitues të programeve të strehimit social, ata përmbushin kriteret thelbësore të përcaktuar nga ligji, atë të të ardhurave të ulta. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, Rregullorja e ERE-së ka fuqi ligjore dhe është e detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e FSHU sh.a. Referuar nenit 83/1 të ligjit nr. 43/2015, FSHU sh.a në cilësinë e furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, është i detyruar të furnizojnë klientët në nevojë, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Sa më sipër rezulton se, ndërprerja e energjisë elektrike për subjektet ankuese, të cilët për shkak të të ardhurave të ulta që disponojnë, përfshihen nga ligji në kategorinë e “klientit në nevojë”, nuk është bërë në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 dhe Rregulloren e ERE-s. Në këto kushte Komisioneri vlerëson se subjektet ankuese janë trajtuar në mënyrë të padrejtë krahasuar me klientët e tjerë, pasi ata nuk ndodhen në kushte e rrethana të njëjta me ata, pikërisht për shkak të gjendjes ekonomike.

Bazuar në nenin 26, të ligjit nr. 22/2018, Bashkia Tiranë ka detyrimin e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite përcaktohet: *“2. Me administrim kuptohen të gjitha veprimet dhe vendimet që merren për pronën, ndër të tjera: a) mbledhja e qirasë; b) evidenca e të ardhurave dhe shpenzimeve; c) planifikimi financiar; ç) mbajtja e bilancit; d) ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve e të drejtave të palëve kontraktuese.”*

Sipas pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 22/2018, kontrata e qirasë lidhet me të drejtë ripërtëritje çdo vit, bazuar në dokumentimin zyrtar që vërteton të ardhurat e çdo individi të familjes.

Rezulton se Bashkia Tiranë nuk ka realizuar asnjë vlerësim të situatës social ekonomike të familjeve të strehuara në kompleksin e banesave sociale të Shkozës.

Bashkia Tiranë, edhe pse iu kërkua informacion i detajuar në lidhje me situatën e furnizimit me energji elektrike të subjekteve ankuese, të strehuara nga bashkia në banesat sociale të kompleksit Shkozë, nuk ndërmori masa proaktive për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe nuk dha shpjegime konkrete në lidhje me ndonjë masë të planifikuar apo të ndërmarrë nga ana e saj për të siguruar furnizimin e rregullt me energji elektrike të familjeve vulnerabël të strehuara në këto banesa. Për më tepër, Bashkia Tiranë nuk mori pjesë në seancën dëgjimore të datës 24.02.2026, pavarësisht njoftimit të rregullt, duke lënë pa përgjigje pyetjet thelbësore të

Komisionerit lidhur me koordinimin institucional me operatorin e shërbimit dhe me masat e parashikuara për evitimin e ndërprerjeve periodike ndaj familjeve në nevojë.

Bashkia Tiranë pretendoi se strehimi i familjeve ankuese në banesat sociale të kompleksit Shkozë është i rregulluar nëpërmjet kontratave të qirasë ose huapërdorjes, dhe se çdo çështje që lidhet me furnizimin me energji elektrike dhe detyrimet përkatëse ndaj operatorëve të shërbimeve publike mbetet jashtë juridiksionit të saj funksional.

Sipas dispozitave të mësipërme të ligjit nr. 22/2018, Bashkia Tiranë ka patur detyrimin që të vlerësojë në mënyrë vjetore situatën e subjekteve ankuese.

Në kushtet kur subjektet ankuese kanë vazhduar të jetojnë në banesat sociale që vetë Bashkia Tiranë i administron si zgjidhje të strehimit social për familjet në nevojë, Bashkia Tiranë nuk i ka siguruar këtyre familjeve një strehim të përshtatshëm, për shkak se familjes i ka munguar furnizimi i rregullt me energji elektrike, në kushtet kur ata janë të ekspozuar ndaj ndërprerjeve të vazhdueshme dhe pa asnjë njoftim paraprak. Pavarësisht faktit që banesat sociale të kompleksit Shkozë ofrojnë akses ndaj rrjetit të furnizimit me energji elektrike, subjektet ankuese e kanë pasur të pamundur sigurimin e furnizimit të rregullt për shkak të strukturës kontraktore të krijuar. Kontratat e energjisë elektrike janë në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të banorëve e cila ka sjellë si pasojë pamundësinë juridike të familjes për të lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pavarësisht gatishmërisë së shprehur për shlyerje graduale me këste mujore të përballueshme.

Sa më sipër, rezulton se subjektet ankues dhe familjet e tyre janë strehuar nga Bashkia Tiranë në banesat sociale të kompleksit Shkozë dhe ndodhen në një situatë vulnerabiliteti ekonomik dhe social, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, pasi nuk iu është siguruar një strehim i përshtatshëm si pasojë e ndërprerjes së furnizimit të rregullt me energji elektrike dhe mungesës së koordinimit institucional nga ana e Bashkisë Tiranë me operatorin e shërbimit për garantimin e këtij shërbimi bazë.

Kështu, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike të subjekteve ankuese, si pasojë e pamundësisë ekonomike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe e mungesës së mekanizmave institucionale që do t'i lejonin familjeve të lidhnin akt-marrëveshje për shlyerje graduale, përbën cenim të rëndë të kushteve thelbësore të jetesës, si dhe goditje të rëndë për dinjitetin njerëzor të të gjithë anëtarëve të familjes.

Në lidhje me procedurën e ndërprerjes, ligji nr. 43/2015 dhe aktet rregullatore të ERE-s parashikojnë procedura strikte që duhet të ndiqen përpara ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë detyrimin për njoftim paraprak të abonentit. Duke qenë se kontrata është në emër të Bashkisë Tiranë, FSHU sh.a kishte detyrimin të njoftonte bashkinë si titullare të kontratës për situatën debitore dhe për ndërprerjen e planifikuar, duke i dhënë asaj mundësinë për të ndërhyrë dhe për të rregulluar situatën përpara ndërprerjes efektive të shërbimit ndaj subjekteve ankuese dhe familjeve të tyre.

Megjithatë, gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të ankesës, as OSHEE sh.a dhe as FSHU sh.a nuk depozituan asnjë dokumentacion provues që të dëshmonte se Bashkisë Tiranë i ishte dërguar ndonjë njoftim paraprak për situatën debitore apo për ndërprerjen e planifikuar të furnizimit me energji elektrike. Të dy institucionet janë mjaftuar me ndërprerjen e furnizimit në kundërshtim me frymën dhe kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, pa marrë në konsideratë rrethanat specifike të subjekteve ankuese dhe familjeve të tyre..

Në lidhje me akt-marrëveshjet, FSHU sh.a ka parashikuar skema vjetore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për të gjitha kategoritë e klientëve. Megjithatë, duke qenë se titullari i kontratës është Bashkia Tiranë, FSHU sh.a kishte detyrimin institucional të bashkërendonte drejtpërdrejt me bashkinë për lidhjen e akt-marrëveshjes dhe për mundësimin e regjistrimit të banorëve si përdorues të kontratës, duke mos e lënë këtë procedurë të bllokuar për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm nga bashkia.

Në cilësinë e operatorit të rrjetit të shpërndarjes, OSHEE sh.a ka detyrime ligjore, sipas ligjit nr. 43/2015 dhe akteve rregullatore të ERE-s, për të garantuar aksesin e pandërprerë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët, duke përfshirë familjet e strehuara në banesa sociale. Çdo ndërprerje e furnizimit duhet të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga rregulloret e ERE-s dhe duhet të shoqërohet me njoftim paraprak të palëve të interesuara, duke përfshirë, në rastet e banesave sociale, edhe autoritetin vendor përgjegjës.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë shqyrtimit të çështjes, Komisioneri arrin në përfundimin se subjektet ankues, të cilët ndodhen në një situatë të dokumentuar vulnerabiliteti ekonomik dhe social, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe jo të barabartë nga ana e Bashkisë Tiranë, FSHU sh.a, dhe OSHEE sh.a pasi nuk ndodhen në kushte dhe rrethana të njëjta me familjet e tjera konsumatore të energjisë elektrike, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike dhe sociale, si banorë të banesave sociale duke u privuar kështu nga aksesin e rregullt dhe i pandërprerë në shërbimin bazë të energjisë elektrike.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkaqet e pretenduara nga ankuesit, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në ankesat objekt shqyrtimi, pretendohet diskriminim për shkak të *“racës”*, *“aftësisë së kufizuar”*, *“gjendjes familjare”*, *“gjendjes civile”*, *“gjendjes shëndetësore”* dhe *“gjendjes ekonomike”*.

Baza e përbashkët e pretendimeve të subjekteve ankues është shkak i gjendjes ekonomike dhe pamundësia financiare si shkak i vetëm dhe vendimtar që i ka çuar ankuesit në situatën e ankimuar pranë Komisionerit.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” Komisioneri gjykon se “*gjendja ekonomike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në nenin 1, të LMD. Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërorë, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës.

Rezultoi e provuar se të gjithë subjektet ankues janë strehuar nga Bashkia Tiranë si familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, të strehuar në kuadër të programeve të strehimit social në banesat sociale në Shkozë pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Sa më sipër, Komisioneri konsideron të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes ekonomike.

Shkaqet e tjera të diskriminimit të pretenduara në ankesat individuale, si gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, gjendja familjare, gjendja civile apo raca, edhe pse përbëjnë shkaqe të mbrojtura sipas nenit 1, të LMD, bazuar në faktet dhe rrethanat konkrete këto shkaqe nuk përbëjnë shkaqet e trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që kundërshtohet në ankesat e ankuesve. Ato potencialisht janë faktorë që shtojnë vulnerabilitetin e çdo ankuesi dhe vështirësojnë ndjeshëm mundësinë e tyre për t'i përballuar pasojat e ndërprerjes së energjisë elektrike, por nuk përbëjnë shkakun e trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që kundërshtohet në ankesat e ankuesve.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shkaqet e diskriminimit raca, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, gjendja familjare dhe gjendja civile, bazuar në faktet dhe rrethanat e ankesave objekt shqyrtimi, nuk janë të bazuara.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur**

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e pabarazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”*. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021).

Neni 52 i Kushtetutës në pikën 2, të tij<sup>39</sup> parashikon se: *“Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarur nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara në ligj”*. Kjo është një shprehje e mbrojtjes sociale, e realizuar përmes përmbushjes së objektivave social, dhe si e tillë realizimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të mundësuar garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>40</sup> është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

GJEDNJ-ja është shprehur se *“e drejta për të mos u diskriminuar kundër gëzimit të të drejtave të garantuara sipas KEDNJ-së dhunohet gjithashtu kur Shtetet... nuk i trajtojnë në mënyra të ndryshme personat, situatat e të cilëve janë shumë të ndryshme”*.

Po kështu, direktivat e BE-së për mbrojtjen nga diskriminimi parashikojnë shprehimisht mundësinë për veprime pozitive, duke përcaktuar se: *“Për të garantuar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk duhet t’i ndalojë Shtetet Anëtare nga pasja ose miratimi i masave konkrete për parandalimin ose kompensimin e disavantazheve të lidhura me “shkaqet e mbrojtura”<sup>41</sup>”*.

Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit European dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, në nenin 7 të saj, citon se: *“ Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cenueshëm, i cili do t’i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike”*.

---

<sup>39</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, Liritë dhe të Drejtat Ekonomike , Sociale dhe Kulturore.

<sup>40</sup> Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

<sup>41</sup> GJEDNJ, *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDN, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002).

Neni 8, i po kësaj Direktive parashikon se: *“Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cenueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë...”*.

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve në disavantazh përforcohet më tej nga udhëzimet e nxjerra nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Këto organe kanë theksuar se masa të tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, duke mos u zgjeruar në kohë dhe fushëveprim përtej çfarë është e nevojshme për trajtimin e pabarazisë në fjalë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në frymën e saj dhe në veçanti, në nenin 25 të saj shprehet se, e drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore e njeriut që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për

të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.* Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pikën 7, se : 7. *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”*

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit ose dështim për të trajtuar ndryshe, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimi në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejtë tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial. Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial). Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon, por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Referuar përkufizimit ligjor elementët diskriminimit e tërthortë janë si më poshtë:

- një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një dispozitë, kriter ose praktikë neutrale. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një kriter që zbatohet për të gjithë. Në rastin konkret, në pamje të parë Bashkia Tiranë nuk i ka trajtuar subjektet ankuese ndryshe apo në mënyrë më pak të favorshme. Po ashtu, FSHU

sh.a dhe OSHEE sh.a kanë zbatuar procedurat e njëjta të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike për të gjithë abonentët debitorë, pa bërë dallim formal ndërmjet tyre.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se kjo dispozitë, kriter ose praktikë neutrale vendos grupin e mbrojtur në një disavantazh të caktuar. Subjektet ankues ndodhen në pamundësi financiare për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, duke mos qenë në gjendje të shlyejnë detyrimet e prapambetura në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë. Subjektet ankues dhe familjet e tyre për shkak të gjendjes së tyre ekonomike referuar procedurave që ndiqen nga ana e autoriteteve publike janë të ekspozuar ndaj një situatë pasigurie për furnizimin me energji elektrike. Në këtë mënyrë, gjendja ekonomike e subjekteve ankues i vendos ata në kushte të pafavorshme, duke i pamundësuar furnizimin e sigurt dhe të rregullt në shërbimin bazë të energjisë elektrike, krahasimisht me familjet e tjera konsumatore që nuk ndodhen në pamundësi ekonomike dhe që disponojnë kontrata të drejtpërdrejta me operatorin e shërbimit.

E drejta për energji elektrike nuk është thjesht një shërbim. E drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore e njeriut, që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese. Një nga referencat e para për të është në nenin 25 (1) të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i konsideruar gjerësisht si instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtës për strehim të përshtatshëm, i referohet të drejtës së secilit për një standard të duhur jetese për vete dhe familjen e tij, përfshirë ushqimin, veshjen e përshtatshme dhe strehimin, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës (neni 11). Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka theksuar se, e drejta për strehim të përshtatshëm nuk duhet të interpretohet ngushtë. Përkundrazi, duhet parë si një e drejtë për të jetuar në siguri, paqe dhe dinjitet. Karakteristikat e së drejtës për strehim të përshtatshëm sqarohen kryesisht në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 (1991) mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe nr. 7 (1997) mbi dëbimet e detyrueshme, të këtij komiteti. Strehimi i përshtatshëm, duhet të sigurojë më shumë se katër mure dhe një çati. Duhet të plotësohen një numër kushtesh të veçanta të strehimit, që të mund të flasim për "strehim të përshtatshëm". Sipas këtyre kritereve, strehimi nuk është i përshtatshëm, nëse banorët e tij nuk kanë ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime të përshtatshme, energji për gatim, ngrohje, ndriçim, ruajtjen e ushqimit ose hedhjen e mbeturinave.

Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura, të pandashme dhe të ndërlidhura. Me fjalë të tjera, shkelja e të drejtës për strehim të përshtatshëm mund të ndikojë në gëzimin e shumë të drejtave të tjera të njeriut dhe anasjelltas. Qasja në strehim të përshtatshëm mund të jetë parakusht për gëzimin e disa të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për punë, shëndetësi, arsim, sigurime shoqërore, të drejtën për të votuar dhe atë për jetën private dhe familjare.

Energjia elektrike është një komponent kryesor dhe thelbësor i strehimit të përshtatshëm, prandaj të jetosh në ditët e sotme pa energji elektrike e bën jetën e secilit të vështirë ose ekstremisht të pamundur. Qasja ndaj energjisë elektrike është një parakusht i pashmangshëm për një strehim të përshtatshëm dhe njëkohësisht është thelbësor për garantimin e të drejtave të tjera, duke siguruar gjithashtu uljen e varfërisë. Mungesa e qasjes ndaj energjisë elektrike është njëkohësisht pasojë e varfërisë, por edhe një nga shkaktarët e saj.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Karta Sociale Europiane nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtës për energji elektrike, por në jurisprudencën e GJEDNJ, mbrojtja e saj ka ardhur si rezultat i gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut. Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut në rastin *Pocasovschi dhe Mihaila kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* (Kërkesa nr. 1089/09) ka vendosur që mungesa e energjisë elektrike, është shkelje e të drejtave të njeriut, pikërisht të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Në këtë çështje gjykata arriti në përfundimin se, burrat e ndaluar në burg pa ujë, energji dhe ngrohje ishin mbajtur në kushte çnjerëzore.

Kushtetuta e Shqipërisë nuk e parashikon të drejtën për strehim në katalogun e të drejtave por në nenin 59 të saj, nën rubrikën “Objektivat socialë”, duke parashikuar që Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon “plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”, si dhe “standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm”. Gjithashtu, po e njëjta dispozitë parashikon që “*Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave*”. Në këtë kuptim, objektivat socialë për t’u realizuar kanë nevojë për miratimin e ligjeve të posaçme, të cilat në parashikimet e tyre njohin njëkohësisht edhe të drejta që bëhen të detyrueshme për zbatim. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 22/2018 “*Për strehimin social*”, i cili ka përkufizuar konceptin “*strehim i përshtatshëm*”, që duhet të garantojë jetën private, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet. Si një nga kushtet thelbësore sipas këtij ligji për një strehim të përshtatshëm është qasja “*në shërbimet publike, si: furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve*”.

E drejta për strehim të përshtatshëm, ku përfshihet e drejta për të pasur energji elektrike, është një e drejtë themelore e njeriut. Si e tillë, shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë akses në energji elektrike, e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e një strehimi të papërshtatshëm.

Në rastin konkret, Bashkia Tiranë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencës të të cilës përfshihen çështjet e strehimit social dhe si titullare e kontratave të furnizimit me energji elektrike për banesat sociale të kompleksit Shkozë, ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që familjet e strehuara prej saj të gëzojnë në mënyrë efektive kushte të përshtatshme strehimi, ku përfshihet edhe e drejta për t’u furnizuar me energji elektrike, në kuptim të nenit 4, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Strehimi i subjekteve ankues në kompleksin Shkozë pa siguruar furnizimin e rregullt dhe të pandërprerë me energji elektrike nuk mund të konsiderohet përmbushje efektive e të drejtës për strehim të përshtatshëm.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni neni 33, pika 7/1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave

*mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Sa më sipër, ankuesja duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>42</sup>

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Komisioneri arrin në përfundimin se subjektet ankues, të cilët ndodhen në një situatë të dokumentuar vulnerabiliteti ekonomik dhe social, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe jo të barabartë nga ana e Bashkisë Tiranë, FSHU sh.a, dhe OSHEE sh.a pasi nuk ndodhet në kushte dhe rrethana të njëjta me familjet e tjera konsumatore të energjisë elektrike, pikërisht për shkak të gjendjes ekonomike duke u privuar kështu nga aksesit i rregullt dhe i pandërprerë në shërbimin bazë të energjisë elektrike.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë subjektet ankues, janë diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, në të drejtën për një strehim të përshtatshëm, për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, institucioneve, i kalon barra e

<sup>42</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf), fq.232.

provës për të provuar se, trajtimi të cilit i janë nënshtruar subjektet ankues, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Në rastin konkret, Bashkia Tiranë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencës të të cilës përfshihen çështjet e strehimit social dhe si titullare e kontratave të furnizimit me energji elektrike për banesat sociale të kompleksit Shkozë, ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që familjet vulnerabël të strehuara prej saj të gëzojnë në mënyrë efektive kushte të përshtatshme strehimi, ku përfshihet edhe e drejta për t'u furnizuar me energji elektrike, në kuptim të nenit 4, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social". Strehimi i subjekteve ankues dhe familjeve të tyre në kompleksin e banesave sociale në Shkozë pa siguruar furnizimin e rregullt dhe të pandërprerë me energji elektrike nuk mund të konsiderohet përmbushje efektive e të drejtës për strehim të përshtatshëm.

Bashkia Tiranë mbajti qëndrim të drejtpërdrejtë lidhur me faktin se çështjet e furnizimit me energji elektrike bien jashtë juridiksionit të saj funksional, por nuk e kundërshtoi pretendimin e subjekteve ankues për ndërprerjet periodike të furnizimit me energji elektrike dhe nuk tregoi se çfarë veprimesh konkrete kishte ndërmarrë për të përmirësuar situatën. Për sa kohë që Bashkia Tiranë nuk ka arritur të sigurojë zgjidhje strukturore për situatën kontraktore të banesave sociale, ajo ka detyrimin që të sigurojë të gjitha kushtet e një strehimi të përshtatshëm, duke bashkërenduar aktivisht me FSHU sh.a dhe OSHEE sh.a për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të familjeve të strehuara në banesat sociale.

Në kushtet kur subjektet ankues, për shkak të gjendjes ekonomike, kanë qenë në pamundësi për të shlyer detyrimet e prapambetura dhe për të lidhur akt-marrëveshje me FSHU sh.a për shkak të strukturës kontraktore të imponuar nga statusi i banesave sociale, Bashkia Tiranë ka pasur detyrimin që të marrë masa për t'i mundësuar familjeve akses të rregullt në furnizimin me energji elektrike, me qëllim sigurimin e kushteve të një strehimi të përshtatshëm.

Komisioneri arrin në përfundimin se, praktika e ndjekur për ndërprerjen e energjisë elektrike, duke i trajtuar ankuesit në mënyrë të njëjtë me të gjithë klientët e tjerë, i vendos ata dhe familjet e tyre në kushte të pafavorshme dhe i ekspozon ndaj pasojave më negative, pasi për shkak të gjendjes së ekonomike dhe pamundësisë financiare, ata e kanë të pamundur të përballojë shpenzimet për pagesën e energjisë elektrike, në raport me klientet e tjerë të cilët nuk janë në të njëjtën gjendje ekonomike dhe pamundësi financiare sikurse subjektet ankues. Ndjekja e kësaj praktike, nuk është objektivisht e justifikuar<sup>43</sup>.

Ndërkohë, OSHEE sh.a, si operator i rrjetit të shpërndarjes, ka pasur detyrimin për të njoftuar paraprakisht Bashkinë Tiranë si titullare të kontratës, përpara çdo ndërprerjeje të furnizimit me energji elektrike ndaj familjeve banore detyrim ky i papërmbushur, siç dëshmohet nga mungesa e plotë e dokumentacionit provues përkatës gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të ankesës.

---

<sup>43</sup> Shiko: Vendimin nr. 38, datë 11.02.2022, të Komisionerit.

Në bazë të fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se në mënyrë të pajustificuar dhe për një kohëzgjatje të konsiderueshme, Bashkia Tiranë, FSHU sh.a dhe OSHEE sh.a nuk kanë ndërmarrë përpjekjet e nevojshme dhe të mjaftueshme për të bërë të mundur furnizimin e rregullt me energji elektrike të subjekteve ankues, në kushtet kur është në detyrimin e tyre respektiv, si njësi e vetëqeverisjes vendore dhe si operatorë të shërbimit universal të energjisë elektrike, që të jenë në dijeni të plotë të situatës së subjekteve ankues, të cilës janë një kategori klientësh në një situatë vulnerabiliteti ekonomik dhe social dhe të veprojnë në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore që u ngarkon kuadri juridik në fuqi. Pretendimi i FSHU sh.a dhe OSHEE sh.a se ata nuk janë në dijeni të situatës së subjekteve ankues pasi marrëdhënia e juridike dhe kontraktore është me Bashkinë Tiranë, si titullare e kontratës së furnizimit me energji elektrike, situata e subjekteve ankues, është e njohur për këto subjekte, pasi situata e ndërprerjes së energjisë elektrike për subjektet ankues është një situatë e përsëritur.

Sa më sipër, të tre institucionet e përfshira Bashkia Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) me veprimet dhe mosveprimet e tyre, i kanë ekspozuar ankuesit në kushte të padrejta dhe të disfavorshme në lidhje me një shërbim bazë jetësor, sikurse është furnizimi me energji elektrike.

Konkretisht, Bashkia Tiranë, në cilësinë e entit administrues të banesave sociale dhe palës kontraktore *de facto* ndaj operatorëve të shërbimeve publike, dështoi të ndërmerre hapat proceduralë për bashkërendimin e veprimeve të nevojshme me OSHEE-n dhe FSHU-n, duke mos siguruar dokumentacionin e domosdoshëm që do t'u kishte mundësuar ankuesve të regjistrohen si abonentë ose klientë të përkohshëm një status i parashikuar shprehimisht nga vetë udhëzimet e OSHEE-së për kategoritë vulnerabël.

Nga ana e tyre, OSHEE sh.a dhe FSHU sh.a edhe pse kishin dijeni për natyrën dhe karakterin e veçantë juridik të këtyre banesave, si dhe pavarësisht ekzistencës së mekanizmave të brendshëm për trajtimin e "klientëve në nevojë", nuk ndërmorën asnjë masë proaktive për të njoftuar autoritetin vendor apo për të ofruar zgjidhje të ndërmjetme, duke e lënë situatën të rëndohet deri në ndërprerjen faktike të furnizimit me energji elektrike, me pasoja direkte për shëndetin dhe dinjitetin e subjekteve ankues.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë, FSHU sh.a dhe OSHEE sh.a, dështuan që të japin një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i janë nënshtruar subjektet ankues dhe familjet e tyre.

Komisioneri arrin në përfundimin se, subjektet ankues dhe familjet e tyre, janë diskriminuar në formën e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Tiranë, OSHEE sh.a dhe FSHU sh.a. Për rrjedhojë Bashkia Tiranë, OSHEE sh.a dhe FSHU sh.a, kanë shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ky ligj në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit ose parandalimin e situatave diskriminuese. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11, 12 dhe 13, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të subjekteve ankues, në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Tiranë, Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a (FSHU sh.a) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a).
2. Bashkia Tiranë duhet të marrë masa të menjëhershme për të garantuar furnizimin me energji elektrike të familjeve ankuese dhe të gjitha familjeve të strehuara në banesat sociale të kompleksit Shkozë, duke bashkërenduar aktivisht me FSHU sh.a. dhe OSHEE sh.a.
3. Bashkia Tiranë duhet të marrë masa për të përcaktuar dhe rregulluar mënyrën se si duhet vepruar për kategorinë e banorëve të banesave sociale që janë në të njëjtat kushte me ankuesit, të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike janë në pamundësi financiare për të siguruar furnizimin me energji elektrike.
4. OSHEE sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të ndërmarrin menjëherë të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e statusit juridik të ankuesve, lidhjen e akt-marrëveshjeve për shlyerjen graduale të detyrimeve të prapambetura duke marrë parasysh të ardhurat faktike të secilit ankues dhe mundësinë e shlyerjes graduale me këste mujore të përballueshme.
5. FSHU sh.a. duhet të ndalojë çdo praktikë ndërprerjeje të energjisë elektrike për klientët fundorë/familjarë të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike ose pagesave sociale/programeve sociale nga shteti, pa respektuar paraprakisht procedurat e parashikuara nga Rregullorja e ERE-s nr. 246, datë 11.12.2018.
6. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, OSHEE sh.a. dhe FSHU sh.a., detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**